



Paneli këshilldhënës për të drejtat e njeriut

Building D, UNMIK HQ Prishtinë/Priština, Kosovo | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

Raporti vjetor 2013



Parathënie

Viti i gjashtë i aktivitetit të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut ndryshonte konsiderueshëm nga ato të periudhës paraprake. Deri në fillim të vitit 2013, të gjitha rastet në zhvillim e sipër (me pak përjashtime) tanimë ishin shpallur të pranueshme. Prandaj, gjatë gjithë vitit, Paneli ishte në gjendje të fokusohej pothuajse vetëm në miratimin e mendimeve mbi bazueshmërinë; duke vendosur nëse dhe deri në çfarë mase faktet e pretenduara nga ankuesit kishin çuar te shkeljet e ndryshme të të drejtave të njeriut nga UNMIK-u.

Gjatë vitit 2013, Paneli dha një numër të mendimeve të rëndësishme. Ato mendime, që veçanërisht meritonin vëmendje, janë nga rastet që përfshijnë pretendimet për mungesë të një hetimi adekuat policor për rrëmbimet, zhdukjet dhe vrasjet në lidhje me obligimin procedural sipas nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe të pretendimeve për shkelje të nenit 3 të Konventës sa i përket viktimave dhe të afërmeve të ngushtë. Rëndësia e së drejtës për të vërtetën gjithashtu është pranuar nga Paneli.

Në këto mendime, dhe po ashtu në rastet e tjera, Paneli vazhdon të elaborojë jurisprudencën e vet, duke marrë parasysh standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që përdoren në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe organet e tjera ndërkombëtare, duke përfshirë në veçanti, Komisionin e OKB-së për të Drejtat e Njeriut.

Paneli kishte shpresuar se ekipi i vogël, por profesional dhe i përkushtuar i juristëve, që ishte mbledhur në vitin 2012, do të mbetej i paprekur në vitin 2013, duke i lejuar Sekretariatit të Panelit që t'i trajtojë shpejt lëndët në zhvillim e sipër dhe me një cilësi të duhur. Kjo madje dukej edhe më shumë se do të ndodhte, duke pasur parasysh që Sekretariati i Panelit e hapi një pozitë shtesë për zyrtar ligjor, që kishte për qëllim të plotësojë zbrazëtinë e krijuar kur kontrata e UNDP-së, e financuar nga Qeveria e Suedisë, përfundoi në pranverën e vitit 2013. Duke ju përgjigjur kërkesës së Panelit, UNMIK-u i mundësoi Sekretariatit që të mbajë një zyrtar ligjor me kontratë të përkohshme, në pritje të përfundimit të procesit të rregullt të rekrutimit. Mirëpo, përkundër pritjeve të Panelit, procesi i rekrutimit akoma nuk ishte përfunduar në fillim të 2014.

Marrë në tërësi, bashkëpunimi i Panelit me UNMIK-un në rastet në vazhdim vazhdoi të jetë i mirë, pavarësisht një numri të vogël të metash. Në përgjithësi, përgjigjet e PSSP-së në mendimet dhe rekomandimet e Panelit kanë qenë shumë më të shpejta sesa në vitet e mëparshme, për sa i përket informimit të publikut për vendimet e marra në përgjigje të mendimeve të Panelit. Përveç kësaj, ankuesit kanë marrë letra nga PSSP-ja, zakonisht pa ndonjë vonesë të madhe. Po ashtu duke sqaruar qëndrimin e tij, PSSP-ja ka shprehur “keqardhjen e tij të thellë” për shkeljet e gjetura të Panelit. Megjithatë, kjo është shumë larg përmbushjes së rekomandimit të përsëritur të Panelit për të kërkuar falje publike për këto shkelje.

Gjithashtu, siç është theksuar tanimë në raportet e mëparshme vjetore, vazhdon të ketë mungesë të treguesve të dukshëm të gatishmërisë në kuadër të sistemit të OKB-së për të siguruar dëmshpërblim adekuat, duke përfshirë kompensimin financiar për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut të identifikuar nga Paneli.

Aktiviteti i Panelit dhe praktika gjyqësore është temë interesimi në rritje, duke përfshirë interesimin në mesin e qarqeve që merren me mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, siç është dëshmuar nga publikimet akademike dhe publikimet e tjera. Përvoja e Panelit tanimë konsiderohet pjesë e rëndësishme e debatit në vazhdim rreth përgjegjësisë së organizatave ndërkombëtare për shkeljet e të drejtave të njeriut, siç vërtetohet me rezolutën e fundit në lidhje me këtë çështje e miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës në janar të vitit 2014. Puna e Panelit duhet parë gjithashtu në dritë të mesazhit të dërguar në kohë të fundit nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së në iniciativën e tij të re “Të drejtat si prioritet”, për të përmirësuar veprimin e OKB-së për të mbrojtur të drejtat e njeriut në gjithë botën.

Marek Nowicki

Kryesues

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut

mars 2014

Përmbajtja

| | |
|--|----|
| 1. Hyrje | 1 |
| 2. Përbërja e Panelit | 2 |
| 2.1. Anëtarët e Panelit..... | 2 |
| 2.2. Stafi i Sekretariatit..... | 6 |
| 2.2.1. Stafi i Sekretariatit që shërbeu në vitin 2013..... | 6 |
| 3. Korniza rregullative | 6 |
| 4. Mediet, OJQ-të dhe materiali ligjor në lidhje me PKDNJ-në..... | 7 |
| 5. Faqja e internetit e Panelit..... | 9 |
| 6. Ngarkesa me lëndë e Panelit..... | 9 |
| 6.1. Statistikat..... | 9 |
| 6.2. Mendimet dhe vendimet e Panelit të përzgjedhura sipas lëndës | 10 |
| 7. Tendencat dhe çështjet për t'u përmendur..... | 11 |
| 8. Jurisprudenca e Panelit | 13 |
| 8.1. Çështjet e pranueshmërisë..... | 14 |
| 8.1.1. Juridiksioni <i>ratione temporis</i> | 14 |
| 8.1.2. Juridiksioni <i>ratione personae</i> | 14 |
| 8.1.3. Juridiksioni <i>ratione materiae</i> | 15 |
| 8.1.4. Lidhja organizative ndërmjet UNMIK-ut dhe OMiK-ut | 15 |
| 8.2. Çështjet e bazueshmërisë..... | 15 |
| 8.2.1. E drejta në jetë– e drejta për hetim efektiv- neni 2 i KEDNJ-së | 15 |
| 8.2.2. Ndalimi i torturës, trajtimit jonjerëzor apo degradues neni 3 i KEDNJ-së | 23 |
| 8.2.3. E drejta për vendim gjyqësor brenda kohës së arsyeshme – neni 6 § 1 i KEDNJ-së | 24 |
| 8.2.4. E drejta për mbrojtje të pronës – e drejta për qasje në gjykatë - neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ-së dhe e drejta për kompensim efektiv - neni 13 i KEDNJ-së | 24 |
| 8.2.5. E drejta për shfrytëzim të patrazuar të pronave – neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ-së..... | 25 |
| 9. Komente dhe rekomandime përfundimtare të Panelit | 25 |
| 10. Reagimet e UNMIK-ut ndaj rekomandimeve të Panelit..... | 27 |
| 11. Lista e shtojcave..... | 30 |
| Shtojca A: Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12..... | 31 |
| Shtojca B: Udhëzimi Administrativ i UNMIK-ut nr. 2009/1..... | 38 |
| Shtojca C: Tabela statistikore e PKDNJ-së..... | 41 |
| Shtojca D: Lista e vendimeve dhe mendimeve të PKDNJ-së të marra në vitin 2013 | 42 |
| Shtojca E: Rastet e mbyllura të PKDNJ-së (të papranueshme, të hedhura poshtë dhe mendimi mbi bazueshmërinë) sipas vitit | 45 |
| Shtojca F: Vendimet dhe mendimet e miratuara sipas vitit..... | 45 |
| Shtojca G: Shkurtesat dhe akronimet | 46 |

1. Hyrje

1. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (Paneli), i themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të 23 marsit të vitit 2006,¹ vazhdoi t'i shqyrtojë ankesat për shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut të kryera nga Misioni i Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), apo që i atribuohen atij, gjatë vitit të gjashtë të funksionimit të tij të plotë në Prishtinë, Kosovë. *Paneli mbetet mekanizmi i vetëm që merret me shkeljet e të drejtave të njeriut, që pretendohet se janë kryer nga Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara apo që i atribuohen atij.* Edhe pse Paneli nuk mund të urdhërojë kompensim apo ndihmë specifike, ai mund të vedosë nëse UNMIK-u është përgjegjës për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe, nëse ky është rasti, ai mund t'i japë rekomandime Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) në Kosovë.
2. Me gjithë mungesat e mëdha të stafit në Sekretariat gjatë një pjese të konsiderueshme të vitit, Paneli arriti të ketë një periudhë shumë të suksesshme të shqyrtimit të ankesave. Ky raport vjetor përfshin periudhën 1 janar 2013 deri më 31 dhjetor 2013, gjatë së cilës kohë Paneli mbajti 11 seanca, duke përfshirë shqyrtimet përmes mjeteve elektronike. Gjatë këtij viti, Paneli miratoi 56 mendime mbi bazueshmërinë (në lidhje me 79 ankesa), gjeti 4 ankesa tjera si të pranueshme apo pjesërisht të pranueshme, 6 ankesa i shpalli të papranueshme dhe 2 kërkesa i hodhi poshtë për rishikim të vendimeve të mëparshme. Nga gjithsej 527 ankesa të regjistruara, disa nga të cilat përfshinë një numër të madh të ankuesve të përmendur me emër, gjithsej 342 tani janë të mbyllura, ndërsa pjesa e mbetur prej 185 ankesave janë në zhvillim e sipër në faza të ndryshme të procedurave. Në vitin 2013, Paneli nxori vendime dhe mendime për 90 raste. Përveç kësaj, Paneli vazhdoi punën e vet të rregullt në të gjitha rastet në zhvillim e sipër.
3. Deri në maj të vitit 2013, Paneli dhe Sekretariati vazhduan të marrin financim nga Qeveria e Suedisë për të siguruar mbështetje për një jurist shtesë, kontrata e të cilit menaxhohej nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP). Paneli gjithashtu u lidh me disa ambasadorë të tjerë nga ambasadat në Kosovë, për të kërkuar financim të mëtejshëm për juristin e sponsoruar nga UNDP, por pa asnjë rezultat pozitiv.
4. Në vitin 2013, kryesuesi i Panelit vizitoi Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg të Francës, ku ai vuri kontakte me kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe gjyqtarët e tjerë të Gjykatës Evropiane.² Këto takime u dëshmuan të jenë jashtëzakonisht të dobishme dhe informatat e shkëmbyera theksuan natyrën e përputhshme të jurisprndencës së të dy institucioneve.
5. Në emër të Panelit, Sekretariati vuri kontakte me Zyrën e Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, organizatën Amnesty International dhe projektin për asistencë ligjore "Mbështetje e mëtejshme për refugjatët dhe PZHB-të në Serbi". Përveç kësaj, Sekretariati u mbajti prezantime studentëve vizitorë nga Qendra Evropiane për studime të magjistraturës mbi të drejtat e njeriut dhe demokratizimin, me seli në Venedik.

¹Bashkëngjitur si shtojca A.

²Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Raporti vjetor 2013*, Strasburg, 2014, f. 55

6. Në vitin 2013, Paneli dhe Sekretariati vazhduan me përdorimin e gjerë të burimeve të tjera për të mbledhur informata, të cilat nuk ishin në gjendje t'i mbledhin nga ankuesit apo parashtrësat e PSSP-së për Panelin. Për shembull, Panelit iu ofruan informata jashtëzakonisht të dobishme, duke përfshirë dokumente relevante hetimore që kanë qenë para kësaj të paarrtshme, nga Zyra e Prokurorisë Speciale në Kosovë, Gjykata Themelore e Mitrovicës (me seli në Vushtrri), Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet e lidhura me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (Dhoma e Posaçme), Agjencia Kosovare e Privatizimit, dhe Zyra për ndërlidhje me gjykatat e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës. Informatat e marra iu komunikuan të gjitha palëve në ankesat para Panelit.
7. Sekretariati gjithashtu vuri kontakt me ankuesit individualë, si dhe organizatat që kanë lidhje me rastet, siç janë Shoqata e Familjeve të të Rrëmbyerve dhe Vrarëve në Kosovë dhe Metohi, për të mbledhur informata relevante kur kërkohet.

2. Përbërja e Panelit

2.1. Anëtarët e Panelit

8. Tre anëtarët e Panelit, të emëruar nga kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të (ri)emëruar nga PSSP-ja në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12, të 1 janarit të vitit 2013, ishin z. Marek Nowicki (Poloni), znj. Christine Chinkin (Mbretëria e Bashkuar/Australi) dhe znj. Françoise Tulkens (Belgjikë)³. Paneli e zgjodhi z. Marek Nowicki si kryesues të tij në janar të vitit 2008 dhe e rizgjodhi atë si kryesues në vitin 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013⁴.
9. Informatat për biografinë e anëtarëve të Panelit janë dhënë në tekstin në vijim.
10. **Marek A. Nowicki** (janar 2007- aktualisht) shtetas polak, avokat i të drejtave të njeriut dhe anëtar i Odës së Avokatëve të Varshavës që nga viti 1987.
11. Z. Nowicki ishte Ombudsperson ndërkombëtar në Kosovë i emëruar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, prej korrikut të vitit 2000 deri në dhjetor të vitit 2005. Ai ishte anëtar i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, nga marsi i vitit 1993 deri më 31 tetor 1999, dhe ishte anëtar nga Polonia i Rrjetit të Bashkimit Evropian të ekspertëve të pavarur për të drejtat themelore nga marsi i vitit 2003 deri në shtator të vitit 2006. Më 2005 ai u emërua nga Komisioni i Ministrave si njëri prej tre kandidatëve për postin e Komisarit për të Drejta të Njeriut të Këshillit të Evropës.
12. Z. Nowicki ishte njëri nga “juristët eminentë” të emëruar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës për të vlerësuar gjendjen ligjore dhe të të drejtave të njeriut në Moldavi (1994) dhe Azerbajxhan (1997). Në vitin 1996 dhe 1998, Këshilli i Evropës i kërkoi atij të shërbejë si ekspert për të drejtat e njeriut gjatë vlerësimit të përputhshmërisë së sistemeve ligjore të Gjeorgjisë dhe Federatës Ruse me standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ai shërbeu si ekspert për të drejtat e njeriut i Komisionit Evropian për

³Emërimi dhe riemërimi i znj. Tulkens nga PSSP-ja përfshin periudhën e njëjtë kohore, por ishte në fuqi prej 14 shtatorit të vitit 2012 deri më 13 shtator 2013 dhe 14 shtator 2013 deri më 13 shtator 2014.

⁴Rregullorja e punës e PKDNJ-së, rregulla 6.

Demokraci përmes ligjit (Komisioni i Venedikut) dhe në Drejtorinë e përgjithshme për të Drejtat e Njeriut dhe Çështje Ligjore të Këshillit të Evropës.

13. Z. Nowicki ishte anëtar themelues i Fondacionit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Varshavë dhe kryetar i tij prej nëntorit të vitit 2003 deri në shkurt të vitit 2008. Aktualisht ai e kryeson Këshillin e Fondacionit. Ai është anëtar i Këshillit këshillëdhënës të Qendrës Ndërkombëtare për Mbrojtje Ligjore të të Drejtave të Njeriut në Londër (INTERIGHTS). Z. Nowicki është autor i dhjetëra librave dhe qindra artikujve mbi të drejtat e njeriut, të publikuara në Poloni dhe në vendet tjera. Ai gjithashtu jep ligjërata për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Institutin Nacional për Administrim Publik në Varshavë. Ai është anëtar i Komisionit përzgjedhës të Çmimit Vaclav Havel për të Drejtat e Njeriut të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.
14. **Christine Chinkin** (shkurt 2010- aktualisht) me shtetësi të dyfishtë britanike/australiane, anëtare e Akademisë Britanike, është aktualisht profesoreshë e së drejtës ndërkombëtare në Fakultetin Ekonomik të Londrës dhe profesoreshë e së drejtës globale në Fakultetin e Drejtësisë William C. Cook të Universitetit të Miçigenit. Ajo është anëtare e Odës së Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit dhe anëtare akademike e Matrix Chambers. Ajo është diplomuar në drejtësi në Universitetin e Londrës, Jelit dhe Sidneit dhe ka mbajtur më parë poste akademike me orar të plotë në Universitetin e Oksfordit, Londrës, Sidneit dhe Sauthamptonit, në Fakultetin e Drejtësisë në Nju Jork dhe në Universitetin Kombëtar të Singaporit.
15. Interesimet kryesore të znj. Chinkin janë e drejta ndërkombëtare publike, veçanërisht e drejta për traktatet, të drejtat e njeriut, me theks në mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të grave, dhe organizatat ndërkombëtare, dhe zgjidhjen e konflikteve vendore dhe ndërkombëtare. Ajo është autore e shumë artikujve mbi çështjet që ndërlidhen me të drejtën ndërkombëtare publike dhe të drejtat e grave, ligjet e Halsburit në Australi, E drejta në marrëdhëniet me jashtë (edicioni i 2-të 2001), Palët e treta në të drejtën ndërkombëtare (1993), bashkautore e Zgjidhja e konfliktit në Australi (edicioni i 2-të 2002), bashkëautore e Kufijtë e të drejtës ndërkombëtare: Një analizë feministe (2000) dhe bashkëautore e Krijimit të së drejtës ndërkombëtare (2007). Nga viti 2004-2012, ajo ishte drejtoreshë e studimeve në Asociacionin Ndërkombëtar për të Drejtën. Ajo është anëtare e Këshillit këshillëdhënës të Qendrës Ndërkombëtare për Mbrojtje Ligjore të të Drejtave të Njeriut në Londër (INTERIGHTS) dhe e Këshillit të IBA-s për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Në prill të vitit 2001 asaj iu nda Certifikata për meritë, e Asociacionit Amerikan për të Drejtën Ndërkombëtare për kontribut të jashtëzakonshëm për diturinë dhe në vitin 2006 Medalja e Asociacionit Goler T. Butcher për kontribute të jashtëzakonshme për zhvillimin apo realizimin efektiv të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut' (me H. Charlesworth).
16. Znj. Chinkin ka qenë konsulente për të drejtën ndërkombëtare e Bankës Aziatike për Zhvillim; për trafikim të grave në Zyrën e Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të OKB-së si dhe për Marrëveshjet e Paqes dhe Çështjet Gjimore në Divizionin e OKB-së për Avancimin e Grave dhe UNIFEM. Ajo ishte eksperte shkencore në një Komision ad hoc të Këshillit të Evropës për hartimin e Konventës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje të vitit 2011. Ajo ishte anëtare e misionit faktmbledhës në Beit Hanoun në pajtim me Rezolutën e Këshillit për të Drejtat e Njeriut të Organizatës

së Kombeve të Bashkuara S 3/1, maj 2008 dhe e misionit faktmbledhës të OKB-së në konfliktin e Gazës në vitin 2009, si dhe misionit faktmbledhës të Këshillit për DNJ të IBA-s përkitazi me sundimin e ligjit në Malavi, në janar të vitit 2012.

17. **Françoise Tulkens** (shtator 2012- aktualisht), shtetase e Belgjikës, ka një doktoratë në drejtësi, magjistraturë në penologji dhe ka diplomuar për mësimdhënie në arsim të lartë (*agrégation de l'enseignement supérieur*) në fushën e drejtësisë.
18. Ajo ishte hulumtuuese në Institutin Max Planck për të Drejtën ndërkombëtare dhe të jashtme penale (Freiburg-im-Breisgau, Gjermani). Ajo ishte profesoreshë në Universitetin Louvain (Belgjikë) dhe ka dhënë mësim në Belgjikë dhe gjithashtu jashtë vendit – si profesoreshë vizitore e Universitetit të Gjenevës, Montrealit, Otavës, Parisit I, Renes, Strasburgut dhe Universitetit Shtetëror të Luizianës – në fushën e së drejtës penale (pjesa e përgjithshme), e drejta krahasuese dhe penale evropiane, e drejta e të miturve dhe sistemet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
19. Nga nëntori i vitit 1998 deri në shtator të vitit 2012, ajo ishte gjyqtare në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke shërbyer si kryetare e sektorit nga janari i vitit 2007 dhe si nënkryetare e Gjykatës nga shkurti i vitit 2011.
20. Znj. Tulkens është autore e shumë publikimeve në fushën e të drejtave të njeriut dhe së drejtës penale dhe gjithashtu bashkëautore e librave për referims: *Introduction au droit penal. Aspects juridiques et criminologiques* (edicioni i 9^{të}, 2010) dhe *Droit de la Jeunesse : Aide, Assistance et Protection* (2000). Ajo gjithashtu bashkëboton: *Code de droit international humanitaire* (edicioni i 6^{të}, 2013), *Kodi i së drejtës ndërkombëtare humanitare* (edicioni i 1^{të}, 2013) dhe *Code de droit international des droits de l'homme* (edicioni i 5^{të}, 2014). Ajo është anëtare e bordeve editoriale të një numri revistash shkencore, në mes tjerash *Revue trimestrielle des droits de l'homme*, *Revista mbi drejtësinë ndërkombëtare penale* dhe *Revista ndëramerikane dhe evropiane për të drejtat e njeriut*.
21. Në vitin 2013 ajo është emëruar si anëtare e Komisionit Shkencor të Agjencisë për të Drejta Themelore (ADTH) të Bashkimit Evropian. Ajo është anëtare e Komisionit Shkencor të Institutit për të Drejtat e Njeriut të Odës së Avokatëve të Brukselit dhe Bordit të Drejtorëve të Akademisë për të Drejtën Evropiane.
22. Ajo mban doktorata nderi nga universitetet e Gjenevës, Limozhit, Otavës dhe Gentit. Ajo ka qenë anëtare me korrespondencë e Akademisë Mbretërore të Belgjikës për Shkencë, Letërsi dhe Arte, që nga viti 2011.
23. Znj. Tulkens aktualisht është kryetare e Bordit të Drejtorëve të Fondacionit Mbreti Baudouin.

2.2. Staf i Sekretariatit

24. Staf i Sekretariatit përbëhet nga një zyrtar ekzekutiv, dy zyrtarë ligjorë dhe dy asistente administrativë.

25. **Andrey Antonov**, shtetas rus, iu bashkua Sekretariatit në qershor të vitit 2011 si zyrtar ekzekutiv. Më herët z. Antonov punoi si hetues në Divizionin për hetime të Zyrës për Kontroll të Brendshëm në selinë e OKB-së (2011), si zyrtar për disiplinë dhe sjellje në misionin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Sudan (2009-2011), si këshilltar ligjor në Zyrën e integruar të Kombeve të Bashkuara në Siera Leone (2008-2009), si zyrtar ligjor në Divizionin penal të Departamentit të Drejtësisë (DD) të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) (2005-2008), dhe si zyrtar ligjor në Sektorin për Integritet Gjyqësor të DD-së së UNMIK-ut (2003-2005). Para se t'i bashkohej Organizatës së Kombeve të Bashkuara, z. Antonov shërbeu në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Rusisë (MPB), si hetues penal në Departamentin për transport të policisë (Anapa, 1996), dhe ligjërues i lartë mbi procedurën penale dhe hetimin penal (Universiteti i Krasnodarit, MPB e Rusisë, 1999-2003). Ai arriti së pari në Kosovë në vitin 2000 si pjesëtar i kontingjentit rus i dërguar nga MPB-ja ruse për të shërbyer në Policinë e UNMIK-ut, ku ai punoi si zyrtar ligjor në Zyrën ligjore të Komisarit të Policisë së UNMIK-ut deri në vitin 2002. Z. Antonov mban gradën e doktoraturës në drejtësi (PhD), i specializuar në procedurën penale, hetimin penal dhe zbulimin e krimit nga Akademia Ligjore e Volgogradit e MPB-së ruse dhe një magjistraturë në drejtësi (LLM) nga i njëjti institucion. Ai është gjithashtu autor i më shumë se 30 publikimeve në periodikët rusë në lidhje me aspekte të ndryshme të hetimeve penale.
26. **Anna Maria Cesano**, shtetase italiane, iu bashkua Sekretariatit në maj të vitit 2011, si specialiste për të drejtat e njeriut e deleguar nga UNDP-ja dhe përmes financimit të siguruar nga Qeveria e Suedisë. Më herët, znj. Cesano punoi si zyrtare për sundim të ligjit në Programin për qasje në drejtësi të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara në Sierra Leone (2010-2011), si zyrtare për ndërlidhje në Zyrën e Komisarit për Refugjatë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Tanzani (2009) dhe si zyrtare për të drejtat e njeriut në Zyrën e integruar të Kombeve të Bashkuara në Sierra Leone (2007-2009). Para se t'i bashkohej Organizatës së Kombeve të Bashkuara, znj. Cesano punoi në Universitetin e Sienës, Itali (2006-2007) si hulumtuuese mbi sistemin evropian për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Znj. Cesano filloi punën për herë të parë në Ballkan në vitin 2005 në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, në Serbi dhe Mal të Zi. Ajo ka magjistruar për të drejtat e njeriut dhe menaxhimin e konflikteve në Universitetin e Pizës për studime të avancuara Sant' Anna dhe mban një magjistraturë në drejtësi nga Universiteti Katolik i Milanos, Itali.
27. **Brandon Gardner**, shtetas amerikan dhe ish-anëtar i Odës së Avokatëve të Pensilvanisë, iu bashkua Sekretariatit si zyrtar ligjor në tetor të vitit 2011. Më herët, z. Gardner shërbeu si këshilltar ligjor në Komisionin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në emër të Misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në Kosovë (2009-2011).

Para kësaj, z. Gardner shërbeu si zyrtar ligjor në Sektorin për marrëdhënie me jashtë të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut dhe në Zyrën ndërlidhëse për sundim të ligjit të UNMIK-ut (2007-2009). Z. Gardner gjithashtu ka ushtruar detyrën e avokatit në Pensilvani (2006-2007). Z. Gardner ka doktoruar në drejtësi në Universitetin e Pitsburgut si dhe ka diplomuar në shkencë politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare në Universitetin e Pitsburgut.

28. **Snezhana Martinoviq**, punonjëse e stafit vendor, ka qenë asistente administrative në Sekretariat që nga dhjetori i vitit 2007. Ajo filloi punën në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në prill të vitit 2000, si asistente administrative në Departamentin e Policisë së UNMIK-ut. Në tetor të vitit 2002, ajo mori detyrën e asistentes administrative në Departamentin e Drejtësisë të UNMIK-ut. Në mars të vitit 2012, posti i znj. Martinoviq u riklasifikua në asistente ligjore.
29. **Adlije Muzaqi**, punonjëse e stafit vendor, ka qenë asistente administrative në Sekretariat që nga shtatori i vitit 2010. Ajo filloi punën në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në tetor të vitit 1999, si asistente administrative në Administratën komunale të UNMIK-ut në Komunën e Vushtrrisë, rajoni i Mitrovicës.

2.2.1. Stafi i Sekretariatit që shërbeu në vitin 2013

30. **Daniel Trup**, shtetas britanik/francez, iu bashkua Sekretariatit në qershor të vitit 2012 si zyrtar ligjor. Pasi u kualifikua si avokat në vitin 2000, z. Trup ka punuar në fushën e të drejtës penale, si në Mbretërinë e Bashkuar ashtu edhe jashtë saj. Para se t'i bashkohej Sekretariatit, z. Trup kishte punuar në Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit, si zyrtar i lartë ligjor në Zyrën e prokurorisë speciale (2009-2012) dhe si zyrtar ligjor në Zyrën e prokurorit në Gjykatën Shtetërore të Bosnjë e Hercegovinës (2008-2009). Z. Trup ka magjistruar në drejtësi, në fushën e së drejtës ndërkombëtare, në Universitetin e Kentit dhe ka diplomuar në fushën e politikës dhe historisë në Universitetin e Londrës. Më 9 shtator 2013, z. Trup iu bashkua Zyrës për asistencë ligjore për stafin në Zyrën për administrim të drejtësisë të Kombeve të Bashkuara në Najrobi, Keni.

3. Korniza rregullative

31. Teksti kryesor legjislativ për veprim të Panelit mbetet Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, e cila i jep Panelit juridiksion të shqyrtojë një varg ankesash për të drejtat e njeriut që i atribuohen UNMIK-ut, sipas dokumenteve vijuese ligjore: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut), Konventa Evropiane për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, Konventa kundër Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit tjetër Më të Dënuarëve dhe Degradues dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijëve. Juridiksioni i përkohshëm i Panelit fillon që nga 23 prilli i vitit 2005.⁵
32. Më 17 tetor 2009, PSSP-ja nxori Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut nr. 2009/1 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut. Ky Udhëzim Administrativ në fakt ndryshon kriteret për pranueshmëri, procedurën për shqyrtimin e ankesave, mënyrën e mbajtjes së shqyrtimeve publike dhe procedurën e emërimit për anëtarë Paneli. Ai rregullon mënyrën e publikimit të komunikatave për shtyp dhe shpalljeve të Panelit. Ai gjithashtu përmban datën e fundit për dorëzimin e ankesave në Panel. Ky Udhëzim Administrativ diskutohet gjerësisht në raportin e Panelit të vitit 2009 në §§ 35-45.

⁵Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, neni 2.

33. Procedura e Panelit përbëhet prej dy fazave: e para ka të bëjë me shqyrtimin e pranueshmërisë së ankesës; dhe e dyta, nëse ankesa shpallet e pranueshme, shqyrtimin e bazueshmërisë së ankesës.⁶ Pranueshmëria bazohet përmes një vendimi formal, që përmban arsyetimin për vendim. Në disa raste Paneli së pari ka marrë vendim për pranueshmëri të pjesshme dhe pastaj i ka përcaktuar çështjet e mbetura të pranueshmërisë përmes një vendimi final, apo trajtuar ato në lidhje me bazueshmërinë. Vendimet janë publikuar në faqen e internetit të Panelit pasi janë informuar palët në procedurë. Nëse Paneli e shpall tërë ankesën, apo një pjesë të saj, të pranueshme, ai pastaj fillon shqyrtimin e bazueshmërisë së ankesës.
34. Nëse ankesa vazhdon të shqyrtohet për bazueshmërinë e saj, Paneli paraqet mendimin e tij nëse kishte shkelje të të drejtave të njeriut që i atribuohet UNMIK-ut, i cili mund të përmbajë rekomandime për PSSP-në.⁷ Pasi t'u jetë dhënë mendimi palëve, ai gjithashtu publikohet në faqen e internetit të Panelit.⁸ Nga ky moment, vetëm PSSP-ja e ruan autoritetin ekskluziv të vendosë nëse do të veprojë në bazë të gjetjeve të Panelit.⁹ Vendimet e PSSP-së publikohen menjëherë në një mënyrë që siguron përhapje dhe qasje të gjerë.¹⁰

4. Mediet, OJQ-të dhe materiali ligjor në lidhje me PKDNJ-në

35. Në vitin 2013, kishte mbulesë të rëndësishme nga mediet të mendimeve të Panelit mbi ankesat në lidhje me personat e zhdukur dhe të vrarë (PZHV), duke filluar nga guri provues i Panelit për mendimin për PZHV në rastin *S.C.* nga dhjetori 2012¹¹. Shtypi lokal serb dhe ai shqiptar publikuan tregime lidhur me mendimet e Panelit për PZHV-të, pasi fati i personave të zhdukur dhe të vrarë vazhdon të jetë një sferë shqetësimi në gjithë rajonin. Disa shembuj përfshijnë: më 7 mars 2013, gazeta serbe *Vesti* publikoi një tregim rreth mendimit të Panelit në rastin *S.C.*, dhe reagimin e komunitetit ndaj mendimit të Panelit;¹² *Vesti* publikoi artikuj rreth dy nga mendimet e Panelit për PZHV-të, rastet *Tomanoviq*¹³ dhe *Agjançiq*;¹⁴ informatat rreth mendimeve të Panelit për PZHV-të u publikuan nga agjencitë serbe të shtypit dhe qarkulluan në faqet serbe të internetit me lajme *Beta* dhe *Tanjug*;¹⁵ një kolumnist në gazetën serbe *Politika* publikoi një kolumne duke theksuar se si Qeveria serbe- kur mbante Presidencën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara nga shtatori 2012 deri në shtator 2013- e humbi rastin të publikojë dështimin e UNMIK-ut për të kompensuar familjet e viktimave për shkeljet e gjetura në mendimet e Panelit për PZHV-

⁶Për përshkrim të mëtejme të procedurës para Panelit, shih Raportin vjetor të Panelit për vitin 2009, në dispozicion në http://www.unmikonline.org/human_rights/documents/annual_report2009.pdf, §§ 48-60.

⁷Rregullorja e UNMIK-ut nr.2006/12, neni 17.1.

⁸Ibid, Neni 17.2.

⁹Ibid, Neni 17.3.

¹⁰Ibid, Neni 17.4

¹¹Për një diskutim të detajuar të *S.C.*, shih Raportin vjetor të Panelit për vitin 2012, §§ 68-70, 85-87.

¹²“UNMIK-u mbyllte syrin kur UÇK-ja vriste”, *Vesti*, 7 mars 2013.

¹³*Vesti*, 18 qershor 2013.

¹⁴*Vesti online*, 23 shtator 2013, në dispozicion në <http://www.vesti-online.com/Vesti/Hronika/346095/Trag-nestao-u-Alba>

¹⁵*Beta*, 12 mars 2013 dhe *Tanjug*, 18 qershor 2013.

të;¹⁶ dhe, më 19 mars 2013, *Koha Ditore* publikoi një tregim rreth mendimit të Panelit në rastin për PZHV B.A.¹⁷

36. Në shtator të vitit 2013, Amnesty International nxori një raport gjithëpërfshirës të quajtur *Trashëgimia e UNMIK-ut në Kosovë: Dështimi për t'u ofruar drejtësi dhe dëmshpërblim të afërmve të të rrëmbyerve*, i cili dokumentoi faktet në përafërsisht njëzet mendime të Panelit për PZHV-të.¹⁸ Në raport gjithashtu sqarohet arsyeimi i Panelit për konstatimin se, UNMIK-u kishte bërë shkelje të të drejtave të njeriut ndaj ankuesve në ato raste dhe shprehet pajtim me gjetjet e Panelit: “Amnesty International konsideron se në periudhën mes qershorit të vitit 1999 dhe dhjetorit të vitit 2008 policët dhe prokurorët ndërkombëtarë të UNMIK-ut, të cilët ishin përgjegjës për hetimin e krimeve sipas të drejtës ndërkombëtare, dështuan të inicojnë hetime të shpejta, efektive, të pavarura, të paanshme dhe të plota në shumë, apo ndoshta madje shumicën e raporteve për zhdukjet dhe rrëmbimet e imponuara”. Në raport gjithashtu theksohen argumentet e UNMIK-ut se, pse nuk ua ka paguar dëmshpërblimet ankuesve, të drejtat e njeriut të të cilëve ishin shkelur, në kundërshtim me rekomandimet e Panelit për UNMIK-un. “Amnesty International e konsideron këtë përgjigje... të përbjë një përpjekje të jashtëzakonshme të UNMIK-ut për të mos pranuar përgjegjësinë e vet për shkeljet e shumë standardeve të të drejtave të njeriut për të cilat ishte themeluar t'i mbështesë dhe e obliguar t'i respektojë”. Përgjigjet e UNMIK-ut në rekomandimet e Panelit do të trajtohen në hollësi më poshtë (shih §§ 97-104).
37. Studiuesi i njohur ndërkombëtar, Manfred Nowak kontribuoi me një artikull rreth mendimit të Panelit në rastin *S.C.*, që u publikua në shtator të vitit 2013 në Pasqyrën ligjore evropiane për të drejtat e njeriut¹⁹. Në përfundim, profesor Nowak tha se “mendimi i tanishëm i PKDNJ-së përbën një vendim pikë referimi të një organi ndërkombëtar ekspertësh në procesin e vështirë të mbajtjes së organizatave ndërkombëtare, duke përfshirë Kombet e Bashkuara, përgjegjëse për shkeljet e të drejtave të njeriut ...Në rastin aktual, do të ishte shumë e rekomandueshme për PSSP-në që të pajtohet me rekomandimet përkatëse për pranimin publik të dështimit të UNMIK-ut për të kryer hetime efektive, t'i kërkojë falje ankueses dhe familjes së saj, dhe t'u kërkojë EULEX-it dhe autoritetet kompetente vendore t'i intensivikojnë hetimet përkatëse penale me qëllim të identifikimit të autorëve dhe sjelljen e tyre para drejtësisë. Ky do të ishte një hap i rëndësishëm në luftimin e mosndëshkueshmërisë së përhapur në Kosovë dhe mundësimin të viktimave që t'i mbajnë organizatat ndërkombëtare përgjegjëse për shkeljen e të drejtave të njeriut”.
38. Qendra franceze “Centre de recherches et d'études sur les droits fondamentaux” (CREDOF) e Université Paris Ouest Nanterre La Défense, në publikimin ‘online’ *Revue des droits de l'homme*, gjithashtu publikoi dy artikuj nga M. Beulay mbi mendimet e

¹⁶*Politika*, 16 tetor 2013 në dispozicion në <http://www.politika.rs/rubrike/Pogledi-sa-strane/Trn-u-oku-Pogledi-sa-...2>

¹⁷ “UNMIK-u dështoi t'i gjejë vrasësit e një qytetari”, *Koha Ditore*, 19 mars 2013.

¹⁸*Trashëgimia e UNMIK-ut në Kosovë: Dështimi për t'u ofruar drejtësi dhe dëmshpërblim të afërmve të të rrëmbyerve*, Amnesty International, 2013, në dispozicion në <http://www.amnesty.org/en/library/info/EUR70/009/2013/en>

¹⁹ M. Nowak, Pasqyrë ligjore evropiane për të drejtat e njeriut 2013, 3, 275-283.

Panelit, lidhur me rastet e B.A.²⁰ dhe Joçiq²¹. Faqja e internetit në gjuhën frënge *Le Courier des Balkans* gjithashtu publikoi një tregim për mendimin e Panelit për PZHV-të në rastin S.C.²², siç bëri edhe ueblogu *TerraNullius*²³. Në një nivel më të përgjithshëm, artikulli nga profesor P. Klein (Université libre de Bruxelles) mbi “Le Panel consultatif des droits de l’homme (*Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut*) de la MINUK: une étape dans le processus de responsabilisation des Nations Unies ?”²⁴ duhet gjithashtu të kujtohet.

5. Faqja e internetit e Panelit

39. Faqja e internetit e Panelit²⁵ u përmirësua edhe më shumë në vitin 2013, për të mundësuar ndërlidhje më të mirë të përdoruesve dhe qasje më të lehtë në vendimet dhe mendimet e Panelit. Faqja e internetit, e cila freskohet çdo muaj, i vendos në listë rastet sipas emrit të ankuesit për të mundësuar qasje në vendimet dhe mendimet e Panelit për një rast të caktuar. Përveç kësaj, Paneli gjithashtu i vendos në listë vendimet dhe mendimet e veta sipas numrit të rastit dhe datës së miratimit, në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe, kështu që personat e interesuar mund të ndjekin zhvillimin e jurisprudencës së Panelit. Në faqen e internetit gjithashtu paraqiten komentet e PSSP-së mbi rekomandimet e Panelit, duke mundësuar një shqyrtim të një rasti të PKDNJ-së në secilën fazë të tij. Në faqen e internetit janë duke u shtuar edhe gjëra të tjera për të përmirësuar qasshmërinë e përdoruesit.

6. Ngarkesa me lëndë e Panelit

6.1. Statistikat

40. Gjatë periudhës raportuese, nuk jaë pranuar ankesa të reja, pasi që 31 marsi 2010 ishte data e fundit për paraqitjen e ankesave të reja. Në periudhën mes viteve 2006 dhe 2010, Paneli pranoi gjithsej 527 ankesa.

41. Gjatë periudhës raportuese, Paneli miratoi 56 mendime mbi bazueshmërinë (lidhur me 79 ankesa), konstatoi 4 ankesa të tjera si të pranueshme apo pjesërisht të pranueshme, i shpalli

²⁰ M. Beulay, “Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (Nations Unies et Art. 2 CEDH) : La décision B.A. c. MINUK, illustration du sérieux d’une solution initialement cosmétique”, *Lettre “Actualités Droits-Libertés” du CREDOF*, 24 prill 2013, në dispozicion në: <http://revdh.org/2013/04/24/human-rights-advisory-panel-minuk-serieux-cosmetique/>

²¹ M. Beulay, “Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (Nations Unies et Art. 3 CEDH) : Un approfondissement inédit de l’obligation des Nations Unies en matière d’enquête”, *Lettre “Actualités Droits-Libertés” du CREDOF*, 27 shtator 2013, në dispozicion në: <http://revdh.org/2013/09/27/human-rights-advisory-panel-obligation-nations-unies-enquete/>

²² “Disparus du Kosovo : la faillite de la MINUK et du protectorat international”, *Le Courier Des Balkans*, 21 mars 2013, në dispozicion në: <http://balkans.courriers.info/article22062.html>

²³ M. Moratti, “Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut e konsideron OKB-në në Kosovë përgjegjëse për dështimin për t’i hetuar zhdukjet e imponuara – tepër pak, tepër vonë?”, *Terra Nullius*, 18 mars 2013, në dispozicion në: <http://terra0nullius.wordpress.com/2013/03/11/the-human-rights-advisory-panel-holds-the-un-in-kosovo-responsible-for-failing-to-investigate-forced-disappearances-too-little-too-late/>

²⁴ P. Klein, “Le Panel consultatif des droits de l’homme (*Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut*) de la MINUK: une étape dans le processus de responsabilisation des Nations Unies ?”, *Perspectives du droit international au 21ème siècle: Liber Amicorum Christian Dominicé*, Martinus Nijhoff, Leiden/Boston, pp. 225-255.

²⁵<http://www.unmikonline.org/hrap/Eng/Pages/default.aspx>

6 ankesa të papranueshme dhe hodhi poshtë 2 kërkesa për rishikim të ish-vendimeve apo mendimeve.

42. Në fund të vitit 2013, kishte 3 raste në zhvillim e sipër para Panelit në fazën e pranueshmërisë, dhe 182 raste në pritje të mendimit mbi bazueshmërinë²⁶. Paneli mbylli 85 raste në vitin 2013²⁷.

6.2. Mendimet dhe vendimet e Panelit të përzgjedhura sipas lëndës

43. Më poshtë janë një numër i vendimeve dhe mendimeve të përzgjedhura të marra në vitin 2013, të vëna në listë sipas lëndës dhe të cilat janë theksuar për diskutim të mëtejshëm në pjesën 8 të këtij raporti:

E drejta në jetë– E drejta për hetim efektiv

- *B.A.*²⁸, 92/09 (mendimi i 1 shkurtit të vitit 2013)
- *Snezhana Zdravkoviq*, 46/08 (mendimi i 25 shkurtit të vitit 2013)
- *C.S.*, 45/09 (mendimi i 25 prillit të vitit 2013)
- *Marija Filipoviq*, 92/09 (mendimi i 25 prillit të vitit 2013)
- *S.P. dhe V.G.J.*, 06/09 & 55/09 (mendimi i 6 qershorit të vitit 2013)
- *Vesna Antiq*, 100/09 (mendimi i 12 shtatorit të vitit 2013)
- *Z.I.*, 145/09 (mendimi i 12 shtatorit të vitit 2013)
- *Milivoje Todorovski*, 81/09 (mendimi i 31 tetorit të vitit 2013)
- *P.S.*, 48/09 (mendimi i 31 tetorit të vitit 2013)
- *G.J.L.*, 88/09 (mendimi i 21 nëntorit të vitit 2013)
- *Olivera Vitosheviq dhe Arsenije Vitosheviq*, 90/09 & 103/09 (mendimi i 27 nëntorit të vitit 2013)
- *Lubica Buleviq*, 146/09 (mendimi i 13 dhjetorit të vitit 2013)
- *R.A.*, 41/09 (mendimi i 13 dhjetorit të vitit 2013)
- *Nenad Stojkoviq*, 87/09 (mendimi i 14 dhjetorit të vitit 2013)

E drejta në jetë– e drejta për hetim efektiv – ndalimi i torturës, trajtimit jonjerëzor apo degradues

- *Svetllana Joçiq*, 34/09 (mendimi i 23 prillit të vitit 2013)
- *Ruhan Ruhani*, 85/09 (mendimi i 5 qershorit të vitit 2013)

E drejta për shfrytëzim të patrazuar të pronave

- *Millorad Rajoviq*, 308/09 (vendimi i 31 janarit të vitit 2013)
- *Millorad Rajoviq*, 308/09 (mendimi i 6 qershorit të vitit 2013)

²⁶Në rastet për të cilat ka mendim të pjesshëm mbi bazueshmërinë, rasti është akoma në pritje të vendimit final mbi bazueshmërinë. Gjithashtu, në vitin 2012, Paneli i rihapi 2 raste që më parë ishin shpallur të papranueshme, *Balaj dhe të tjerët* dhe *N.M. dhe të tjerët*.

²⁷Për statistika të detajuara, shih shtojcën C.

²⁸Ankuesit kërkuan anonimitet.

E drejta për shfrytëzim të patrazuar të pronave – e drejta për vendim gjyqësor brenda kohës së arsyeshme – ndalimi i torturës, trajtimit jonjerëzor apo degradues – ndalimi i diskriminimit – e drejta në sigurim social dhe një standard adekuat jetese

- *Tomë Krasniqi*, 08/10 (vendimi i 6 qershorit të vitit 2013)

E drejta për shfrytëzim të patrazuar të pronave – e drejta për kompensim efektiv – e drejta për vendim gjyqësor brenda kohës së arsyeshme

- *Marija Laliq*, 31/08 (mendimi i 14 marsit të vitit 2013)
- *Jugobanka A.D. nën likuidim I*, 57/10 (vendimi i 6 qershorit të vitit 2013)

E drejta për vendim gjyqësor brenda kohës së arsyeshme

- *Vlladimir Manohin*, 27/09 (mendimi i 2 gushtit të vitit 2013)

7. Tendencat dhe çështjet për t'u përmendur

44. Në vitin 2013, prioritet numër një i Panelit ishte shqyrtimi i rasteve lidhur me hetimet e pretenduara joefektive në rastet e PZHV-e. Në praktikë, kjo nënkuptonte që Paneli t'i japë mendimet për gjithsej 72 raste të PZH-ve. Në 71 nga këto 72 raste, Paneli gjeti se UNMIK-u kishte bërë shkelje të obligimit procedural që rrjedh nga e drejta në jetë, e garantuar me nenin 2 të KEDNJ-së. Në mënyrë specifike, Paneli gjeti se UNMIK-u e kishte shkelur obligimin procedural të nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për shkak të mosefektivitetit të hetimit të vet për rrëmbimet, zhdukjet dhe/apo vrasjet e të afërmeve të ankuesve.
45. Siç është diskutuar gjerësisht më lart, Paneli e zhvilloi jurisprudencën e vet dhe e qartësoi më tutje sqarimin e vet se, pse hetimet nuk plotësuan standardet e hetimeve siç kërkohet me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Një pjesë interesante ishte diskutimi i Panelit lidhur me të drejtën në të vërtetën, e cila filloi në rastin e *G.J.L.* Duke vënë në dukje jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Paneli theksoi, “Gjykata gjithashtu ka theksuar rëndësinë e madhe të hetimit efektiv për gjetjen e së vërtetës së çfarë ka ndodhur, jo vetëm për familjet e viktimave por gjithashtu edhe për viktimat e tjera të krimeve të ngjashme, dhe gjithashtu publikun e gjerë, të cilët kanë të drejtë të dinë se çfarë ka ndodhur. Organizata e Kombeve të Bashkuara gjithashtu pranon rëndësinë e së drejtës për të ditur të vërtetën. Sipas Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, “e drejta për ta ditur të vërtetën nënkupton njohurinë e tërë dhe të plotë rreth shkeljeve dhe ngjarjeve që kanë ndodhur, rrethanat e tyre specifike dhe kush mori pjesë në to. Në rastin e personave të zhdukur ... ajo gjithashtu nënkupton të drejtën për të ditur për fatin dhe vendndodhjen e viktimës.” Shih PKDNJ, *G.J.L.*, nr. 88/09, mendimi i 21 nëntorit të vitit 2013, § 88.
46. Përveç kësaj, Paneli gjeti për herë të parë se UNMIK-u kishte bërë shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së në mënyrë specifike për sa i përket të drejtave të të afërmeve të viktimave që të jenë të lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues. Paneli së pari elaboroi arsyetimin e vet në lidhje me shkeljet e nenit 3 në rastin e vet *Joçiq*; më pas, Paneli elaboroi jurisprudencën e vet lidhur me nenin 3.

47. Lidhur me nenin 3 të KEDNJ-së, Paneli thekson që obligimi sipas nenit 3 të KEDNJ-së dallon nga obligimi procedural mbi autoritetet sipas nenit 2. “Ndërsa i fundit kërkon nga autoritetet të ndërmarrin veprim specifik ligjor, që është në gjendje të çojë kah identifikimi dhe dënimi i atyre që janë përgjegjës, i pari është më i përgjithshëm dhe humanitar dhe lidhet me reagimin e tyre ndaj gjendjes së vështirë të të afërmeve të atyre që janë zhdukur apo kanë vdekur.” Pastaj, Paneli diskutoi jurisprudencën e Këshillit për të Drejtat të Njeriut të OKB-së dhe KEDNJ-së lidhur me nenin 3 të KEDNJ-së duke vënë në dukje se “Gjykata Evropiane gjithashtu merr parasysh rrethanat vijuese: kohëzgjatjen e zhdukjes dhe periudhën pa informata mbi fatin e personit të zhdukur dhe hetimin e zhvilluar nga autoritetet; vonesën në nisjen e hetimit penal për zhdukjen; mungesën e ndonjë veprimi “kuptimplotë” nga autoritetet, pavarësisht nga fakti që ankuesit iu janë drejtuar atyre për të raportuar zhdukjen e të afërmeve të tyre dhe të ndajnë me ata informatat që i kanë pasur; mungesa e ndonjë sqarimi apo informate bindëse për fatin e të afërmeve të tyre të zhdukur, pavarësisht pyetjeve personale dhe atyre me shkrim për organet zyrtare.”
48. Paneli ka pranuar se “Gjykata Evropiane tashmë ka gjetur shkeljet e nenit 3 të KEDNJ-së në lidhje me zhdukjet, në të cilat shteti u gjet të jetë përgjegjës për rrëmbimet. Megjithatë, në kontrast, në rastin në shqyrtim të Panelit, UNMIK-u nuk është i implikuar në asnjë mënyrë në zhdukjen aktuale dhe UNMIK-u nuk mund të jetë përgjegjës për shqetësimin mental të parashtrueses, të shkaktuar nga kryerja e krimit.”
49. Megjithatë në rastin *Joçiq*, Paneli gjeti se UNMIK-u i kishte kontribuar shqetësimin dhe vuajtjes mentale të ankueses nga mënyra se si autoritetet e UNMIK-ut e kanë trajtuar rastin e djalit të saj të zhdukur dhe kështu ia kanë pamundësuar asaj të zbulojë se çfarë i ka ndodhur djalit të saj. Paneli theksoi se “ankuesja nuk është kontaktuar kurrë as nga Policia e UNMIK-ut e as nga prokurorët, se deklarata e saj kurrë nuk ishte regjistruar dhe se ajo nuk ishte informuar kurrë për progresin e hetimit. Paneli rithekson që nga këndvështrimi i nenit 3 mund t’i shqyrtojë reagimet dhe qëndrimet e UNMIK-ut ndaj ankueses në tërësinë e vet. Siç është treguar për sa i përket nenit 2, dosja e paraqitur nuk ofron asnjë detaj të ndonjë komunikimi ndërmjet autoriteteve hetimore të UNMIK-ut dhe ankueses nga koha e përpilimit të raportit fillestar për zhdukjen.”
50. Paneli përfundoi se “ankuesja përjetoj shqetësim të rëndë dhe dhimbje për një periudhë kohore të zgjatur dhe të vazhdueshme, nga mënyra se si autoritetet e UNMIK-ut e kanë trajtuar ankesën e saj dhe si rezultat pamundësisë së saj për të zbuluar se çfarë i ka ndodhur djalit të saj. Në lidhje me këtë, është e qartë që, në çdo situatë, dhimbja e një nëne, e cila duhet të jetojë në pasiguri rreth fatit të djalit të saj të zhdukur, është e padurueshme. Për arsyet e përmendura më lart, Paneli përfundon që, me sjelljen e vet, UNMIK-u i ka kontribuar shqetësimin dhe vuajtjes mentale të ankueses, duke shkelur nenin 3 të KEDNJ-së.” Shih PKDNJ, *Joçiq*, nr. 34/09, mendimi i 23 prillit të vitit 2013, §§ 21-26, 85, 102-104, 122-125.
51. Përveç në rastin *Joçiq*, në vitin 2013 Paneli vendosi se UNMIK-u kishte shkelur nenin 3 të KEDNJ-së në 52 raste të tjera. Në të gjitha këto raste, Paneli i dha rekomandime UNMIK-ut se si t’i adresojë këto shkelje. Në mesin e formave tjera të dëmshpërblimit, Paneli rekomandoi që UNMIK-u t’u kërkojë zyrtarisht falje publike ankuesve dhe familjeve të tyre për vuajtjen dhe dhembjen e shkaktuar nga mosveprimi dhe shkelja e detyrës nga ana e

UNMIK-ut. Për më shumë lidhur me rekomandimet e Panelit për UNMIK-un, shih §§ 91-96, më poshtë.

52. Në vitin 2013, Paneli ishte i inkurajuar të theksojë se përgjigjet e PSSP-së ndaj rekomandimeve të Panelit në mendime ku përcaktoi se UNMIK-u kishte bërë shkelje të të drejtave të njeriut ishin të gatshme me një ritëm shumë më të shpejtë sesa në vitet e mëparshme²⁹.
53. Përveç çështjeve të lidhura me nenet 2 dhe 3 të KEDNJ-së të përmendura më lart, Paneli vazhdoi të shqyrtojë rastet e lidhura me çështjet vijuese ligjore:
- Pretendimet për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të drejtës për vendim të gjyqit brenda një kohe të arsyeshme (neni 6 § 1 i KEDNJ-së);
 - Pretendimet për shkelje të së drejtës për dëmshpërblim efektiv (neni 13 i KEDNJ-së);
 - Pretendimet për shkelje të së drejtës për të qenë i lirë nga diskriminimi (neni 14 i KEDNJ-së);
 - Pretendimet për shkelje të së drejtës për shfrytëzim të të patrazuar të pronave dhe së drejtës për mbrojtje të pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së); dhe
 - Pretendimet për shkelje të së drejtës për sigurim social dhe standard adekuat jetese (neni 9 dhe 11 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulture).
54. Përveç kësaj, Paneli ka vazhduar punën në rastet kryesore për të cilat pret të japë mendimet në vitin 2014. Për shembull, Paneli pret të japë mendim lidhur me rastin *Balaj*, që përfshin pretendimin për shkelje të së drejtës përjetë (neni 2 i KEDNJ-së). Në rastin *Balaj*, ankuesit pretendojnë se Policia e UNMIK-ut përdori forcë të tepërt gjatë një operacioni për vënien nën kontroll të turmës në Kosovë më 17 shkurt 2007, që rezultoi me vdekjen e dy viktimave dhe lëndim serioz trupor të dy viktimave të tjera. Gjithashtu, Paneli pret të japë një mendim lidhur me rastin *N.M. dhe të tjerët*, lidhur me pretendimet për shkelje të së drejtës për jetë, (neni 2 i KEDNJ-së) ndalimi i trajtimit jonjerëzor dhe degradues (neni 3 i KEDNJ-së) dhe të së drejtës për respektim të jetës private dhe familjare (neni 8 i KEDNJ-së), në mes tjerash. Në rastin *N.M. dhe të tjerët*, ankuesit, të cilët janë 143 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, pohojnë të kenë pësuar helmim nga plumbi dhe probleme të tjera shëndetësore për shkak të kontaminimit të tokës në kampe, për shkak të afërsisë së kampeve me shkretoren e Trepçës dhe kompleksin e minierave dhe/apo për shkak të higjienës dhe kushteve jetësore përgjithësisht të këqija në kampe.

8. Jurisprudenca e Panelit

55. Në vitin 2013, Paneli vazhdoi të ketë progres të rëndësishëm në zgjidhjen e ngarkesës me lëndë. Me mbylljen e 85 rasteve që ishin në listën e tij, Paneli dha vendime dhe mendime përfundimtare për ankuesit, ndërsa njëkohësisht zgjeronte jurisprudencën në një numër çështjesh të reja procedurale dhe esenciale. Disa vendime dhe mendime të rëndësishme të dhëna nga Paneli në vitin 2013 përshkruhen në më shumë detaje më poshtë.

²⁹Paneli shprehu shqetësim në Raportin vjetor të PKDNJ-së për vitin 2012 lidhur me mungesën e publikimit të reagimeve publike të PSSP-së ndaj rekomandimeve të Panelit. Për më shumë informata, shih Raportin vjetor të PKDNJ-së për vitin 2012 §§ 88-91.

8.1. Çështjet e pranueshmërisë

8.1.1. Juridiksioni *ratione temporis*

56. Kur ankuesi pretendon shkelje të obligimit esencial të nenit 2 të KEDNJ-së, që rrjedh nga vdekja e anëtarit të familjes që ka ndodhur para fillimit të juridiksionit të Panelit më 23 prill 2005, kjo ankesë konsiderohet se i referohet një ngjarje të menjëhershme që nuk ka sjellë një situatë të vazhdueshme. Si e tillë, ajo bie jashtë juridiksionit *ratione temporis* të Panelit. Shih PKDNJ, *Zdravkoviq*, lënda nr. 46/08, mendimi i 25 shkurtit të vitit 2013, § 77.

8.1.2. Juridiksioni *ratione personae*

57. Në rastin *Jugobanka nën likuidim I*, ankuesja pretendoi se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet e lidhura me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (Dhoma e Posaçme), duke lëshuar një moratorium mbi ndonjë çështje gjyqësore për sa i përket minierave të Trepçës, ka vonuar procedurat e Dhomës së Posaçme dhe i mohoi asaj të ketë një vendim brenda kohës së arsyeshme, duke shkelur nenin 6 § 1 të KEDNJ-së. Paneli theksoi se gjatë kësaj kohe, ankuesja ka qenë nën administrim të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave të Serbisë, ankesat e së cilës Paneli i gjeti në rastin e tij të mëparshëm *Agjencia e Sigurimit të Depozitave* të jenë jashtë juridiksionit të tij *ratione personae*. Duke vënë në dukje se Agjencia e Sigurimit të Depozitave e Serbisë ushtroi kontroll të ngushtë mbi ankuesen, Jugobanka SH.A., dhe duke vënë në dukje jurisprudencën e KEDNJ-së në rastet e krahasueshme që përfshijnë bankat serbe ku Serbia kishte ushtruar kontroll të ngushtë mbi bankat serbe, Paneli vendosi që ankesa e Jugobanka SH.A. ishte jashtë juridiksionit të vet *ratione personae*. Shih PKDNJ, *Jugobanka nën likuidim I*, lënda nr. 57/10, vendimi i 6 qershorit të vitit 2013, §§ 22-25.

58. Në rastin *Krasniqi*, ku ankuesi pretendoi se ai nuk ishte në gjendje të marrë përfitimet e tij pensionale nga Fondi pensional jugosllav pas arritjes së UNMIK-ut në vitin 1999, PSSP-ja argumenton se ankesa ishte jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit, pasi fondi administrohej nga autoritetet në Beograd. Paneli nuk u pajtua, duke theksuar se “praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane tregon se shfrytëzimi efektiv i të drejtës së mbrojtur me nenin 1 të Protokollit nr. 1 ‘nuk varet vetëm nga detyra e shtetit për të mos ndërhyrë, por mund të kërkojë miratimin e masave pozitive të mbrojtjes, veçanërisht ku ka një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet masave që një parashtrues ligjshëm mund t’i presë nga autoritetet dhe shfrytëzimit efektiv të pronave të tij”. Paneli gjithashtu theksoi “se, në rrethanat e rastit aktual, dhe në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999), UNMIK-u është mandatar, ‘në pritje të zgjidhjes përfundimtare’, me administrim të përkohshëm të Kosovës pa paragjykim për ‘sovrانيتin dhe integritetin territorial të Republikës Federale të Jugosllavisë’. Në lidhje me këtë, Paneli i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane se, në rast të një situatë faktike, e cila zvogëlon shtrirjen e juridiksionit të autoritetit në fjalë – në këtë rast UNMIK-u *vis-à-vis* autoriteteve të Beogradit-shteti në fjalë duhet bërë përpjekje, me të gjitha mjetet ligjore dhe diplomatike në dispozicion *vis-à-vis* shteteve të huaja dhe organizatave ndërkombëtare, të vazhdojë që të garantojë shfrytëzimin e të drejtave dhe lirive të garantuara me Konventë. Për këto arsye,

Paneli konsideron se ankesa sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së bie brenda juridiksionit *ratione personae* të Panelit në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 dhe hedh poshtë vërejtjen e PSSP-së në lidhje me këtë”. Shih PKDNJ, *Krasniqi*, lënda nr. 08/10, vendimi i 6 qershorit të vitit 2013, §§ 29-31.

8.1.3. Juridiksioni *ratione materiae*

59. Në rastin e njëjtë, *Krasniqi*, PSSP-ja argumentoi se përfitimet pensionale të ankuesit nuk ishin prona “të caktuara” sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1, dhe se një çështje e tillë ishte jashtë juridiksionit *ratione materiae* të Panelit. Paneli nuk u pajtua, duke theksuar se “Gjykata [Evropiane] ka konsideruar gjithashtu se aty ku është në fuqi legjislacioni që parasheh pagesën si e drejtë për një pension, ai legjislacion duhet vlerësuar si ‘gjenerues i interesit të pronarit’ duke rënë kështu në kuadër të nenit 1 të Protokollit nr. 1 për personat që plotësojnë kërkesat e veta dhe se zvogëlimi apo ndërprerja e pensionit mundet së këndejmi të përbëjë një pengesë për shfrytëzim të qetë të pronave. Prandaj, Paneli konsideron se kjo pjesë e ankesës bie në kuadër të juridiksionit *ratione materiae* të Panelit dhe hedh poshtë vërejtjen e PSSP-së në lidhje me këtë”. Shih PKDNJ, *Krasniqi*, lënda nr. 08/10, e përmendur në § 58 më lart, në §§ 27-28.

8.1.4. Lidhja organizative ndërmjet UNMIK-ut dhe Misionit të OSBE-së në Kosovë

60. Në rast se Misioni i OSBE-së në Kosovë (OMiK) ka zënë pronën e ankuesit në periudhën mes 1 marsit të vitit 2000 dhe 1 nëntorit të vitit 2007, ankuesi mund të ngritë një çështje lidhur me të drejtat e tij sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së që i atribuohen UNMIK-ut, pavarësisht faktit se OMiK-u përfaqësoi një shtyllë të veçantë të pranisë ndërkombëtare në Kosovë. Autoriteti i OMiK-ut për t’i marrë objektet e ankuesit gjatë kësaj periudhe kohore, mund të ketë rrjedhur vetëm nga përfshirja e OMiK-ut në kornizën administrative të UNMIK-ut dhe Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara 1244 (1999). Shih PKDNJ, *Rajoviq*, lënda nr. 308/09, vendimi i 31 janarit të vitit 2013, §§ 18-21.

8.2. Çështjet e bazueshmërisë

8.2.1. E drejta në jetë– e drejta për hetim efektiv- neni 2 i KEDNJ-së

Mungesa e dosjes hetimore

61. Në rastin *B.A.*, ku UNMIK-u nuk ishte në gjendje t’i ofrojë Panelit ndonjë dosje lidhur me hetimin për zhdukje dhe vdekje të viktimës, Paneli vendosi të shqyrtojë bazueshmërinë e ankesës vetëm në bazë të dokumenteve të vëna në dispozicion nga ankuesi dhe informatat e pakta të ofruara nga UNMIK-u, dhe të nxjerrë konkluzione nga kjo situatë. Paneli theksoi se në nenin 15 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, thuhet që Paneli mund të kërkojë dorëzimin nga UNMIK-u të çdo dokumenti dhe që PSSP-ja të bashkëpunojë me Panelin dhe të sigurojë ndihmën e nevojshme duke përfshirë, në veçanti, lëshimin e dokumenteve dhe informatave relevante për ankesën”. Paneli iu referua praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që duhet nxjerrë konkluzione nga sjellja e palës së paditur gjatë procedurave, duke përfshirë dështimin e vet “për t’i dorëzuar informatat në

duart e tyre pa një sqarim të kënaqshëm”. Shih PKDNJ, *B.A.*, lënda nr. 52/09, mendimi i 1 shkurtit të vitit 2013, §§ 46-49.

62. Në rastin *B.A.*, Paneli gjithashtu theksoi që ruajtja e duhur e dosjeve hetimore lidhur me krimet siç janë vrasjet dhe zhdukjet, nga hapja e hetimit deri te dorëzimi i tyre, është vendimtare për vazhdimin e hetimeve të tilla dhe dështimi për ta bërë këtë mund t’i ngritë çështjet *vetvetiu* sipas nenit 2. Shih PKDNJ, *B.A.*, lënda nr. 52/09, përmendur në § 61 më lart, në § 48.
63. Në rastine *C.S.*, ku UNMIK-u nuk ishte në gjendje t’i ofrojë Panelit ndonjë dosje lidhur me hetimin për zhdukjen dhe vdekjen e viktimës, PSSP-ja argumentoi se hetimi i mjekësisë ligjore për rastin duhet të jetë i ndarë nga elementi penal dhe gjyqësor. “Për sa i përket komponentit të mjekësisë ligjore, PSSP-ja pohon se një hetim i plotë ishte bërë nga Policia e UNMIK-ut, që çoi te gjetja dhe identifikimi i mbetjeve mortore të [viktimave]. Prandaj, nuk kishte shkelje të këtij komponenti të nenit 2 të KEDNJ-së, i cili mund t’i atribuohet UNMIK-ut”. Paneli nuk u pajtua, duke theksuar se megjithëse gjetja dhe identifikimi imbetjeve mortore është *vetvetiu* një arritje e rëndësishme, “obligimi procedural sipas nenit 2 nuk përfundoi me gjetjen e mbetjeve mortore, veçanërisht pasi rrethanat treguan shenja të një vdekje të dyshimtë dhe vdekje të dhunshme në [lidhje me viktimat]. Megjithatë, nuk ka asnjë dëshmi se është ndërmarrë ndonjë veprim për sa i përket qartësisë të rrethanave që ndërlidhen me zhdukjen dhe vdekjen e [viktimave]. Si rezultat, obligimi i UNMIK-ut për të hetuar këtë rast nuk përfundoi me gjetjen dhe identifikimin e mbetjeve mortore të [viktimave]. Prandaj, Paneli përfundon se observimi i PSSP-së se UNMIK-u nuk shkeli nenin 2 të KEDNJ-së për shkak se e kishte gjetur vendin e këtyre trupave, nuk është *vetvetiu* i mjaftueshëm për t’u liruar nga obligimi i tij në këtë drejtim”. Shih PKDNJ, *C.S.* lënda nr. 45/09, mendimi i 25 prillit të vitit 2013, §§ 47,80.

Marrëdhënia ndërmjet hetimit të UNMIK-ut dhe autoriteteve të tjera hetimore

64. Në rastin *Antiq*, ku UNMIK-u nuk ishte në gjendje t’i ofrojë Panelit ndonjë dosje lidhur me hetimin për zhdukjen dhe vdekjen e viktimës përveç një e-maili, PSSP-ja argumentoi se “hetimi për vdekjen e [viktimës] mund të ketë qenë pjesë e një hetimi më të gjerë për krime lufte të kryera nga Policia e UNMIK-ut dhe prokurorët ndërkombëtarë të UNMIK-ut, e cila mund të sqarojë mungesën e ndonjë dosje hetimore. Duke u bazuar në informatat e marra nga UNMIK-u, nuk mund të pohohet se hetimi që kishte për qëllim identifikimin dhe sjelljen para drejtësisë të atyre që ishin përgjegjës për vdekjen e [viktimës], ishte i suksesshëm dhe se ka mundësi që të ekzistojnë informata shtesë dhe bindëse. Paneli nuk e pranoi këtë argument, duke theksuar se “një argument i tillë duhet mbështetur me diçka më shumë se një e-mail i vetëm, në të cilin ankuesja vetëm përmendet me emër si dëshmitare në një incident tjetër në zonë, i cili ndodhi pothuaj nëntë muaj para vrasjes së [viktimës]. Pasi nuk ishte ofruar një dëshmi e tillë shtesë nga UNMIK-u, Paneli hedh poshtë këtë argument.” Shih PKDNJ, *Antiq* lënda nr. 100/09, mendimi i 12 shtatorit të vitit 2013, §§ 42, 75.

Asnjë hetim nga UNMIK-u-shkalla e lartë e krimit

65. Në rastin *ZH.I.*, ku PSSP-ja pranoi se Policia e UNMIK-ut me sa duket nuk bëri hetim për vrasjen e viktimës, PSSP-ja deklaroi se rrethanë tjetër për t’u marrë parasysh për vlerësimin e efektivitetit të hetimit ishte fakti se vrasja ndodhi kur shkalla e krimit në Kosovë ishte më e larta, në qershor të vitit 1999, pas bombardimeve të NATO-s. Sipas PSSP-së, gjatë viteve 1999 dhe 2000 UNMIK-u pranoi qindra raporte për zhdukjet dhe vrasjet e serbëve të Kosovës, të cilat ishte veçanërisht sfiduese për t’i hetuar për shkak të burimeve të kufizuara dhe gjithashtu mungesave të pistave të hetimit; largimi masiv i serbëve të Kosovës për në Serbi e kishte bërë sfiduese gjetjen e dëshmitarëve. Në përgjigje të kësaj, Paneli theksoi, “se për të qenë ky argument i vlefshëm, ai duhet mbështetur me të dhëna statistikore. Pasi asnjë e dhënë e tillë nuk ishte ofruar nga PSSP-ja, Paneli e hedh poshtë këtë argument”. Paneli gjeti se “hetimi për vrasjen e [viktimës] nuk ishte adekuat dhe nuk ishte në pajtim me kërkesat për shpejtësi, ekspeditivitet dhe efektivitet siç kërkohet sipas nenit 2”. Shih PKDNJ *ZH.I.*, nr. 145/09, mendimi i 12 shtatorit të vitit 2013, §§ 52, 91-92.

Mungesa e dosjes hetimore – pesha e dëshmisë

66. Në rastin *B.A.*, ku UNMIK-u nuk ishte në gjendje t’i ofrojë Panelit ndonjë dosje lidhur me hetimin për zhdukjen dhe vdekjen e viktimës, Paneli konsideroi se kjo ngriti çështjen e peshës së dëshmisë. Në mënyrë specifike, Paneli ndoqi të dyja, jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe Komisionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (KDNJ) dhe vendosi se, “meqë dokumentacioni ishte nën kontrollin ekskluziv të autoriteteve të UNMIK-ut, së paku deri te dorëzimi tek EULEX-i, parimi se ‘konkluzione të forta’ mund të nxirren nga mungesa e dokumentacionit është i aplikueshëm”. Shih PKDNJ, *B.A.*, lënda nr. 52/09, përmendur në § 61 më lart, në §§ 50-53.

67. Paneli gjithashtu theksoi se “sipas Raportit vjetor të vitit 2000 të Policisë së UNMIK-ut, së paku deri në mesin e shtatorit të vitit 1999, i gjithë sistemi i hetimit penal në rajonin e Prishtinës ishte nën kontrollin e plotë të UNMIK-ut. Prandaj, ishte përgjegjësi e UNMIK-ut të sigurojë, *e para*, që hetimi të kryhet në mënyrë ekspeditive dhe efikase; *e dyta*, që i gjithë materiali relevant hetimor t’i dorëzohet siç duhet autoritetit që merr përgjegjësinë për hetim; dhe *e treta*, që dosjet hetimore të mund të zbulohen dhe të merren nëse ka nevojë në ndonjë fazë të mëvonshme”.

68. Meqë UNMIK nuk ka siguruar ndonjë dosje hetimore, Paneli përfundoi “se ka ndodhur një nga situatat vijuese: nuk është kryer kurrfarë hetimi; UNMIK me qëllim ka zgjedhur mos t’ia paraqesë dosjen Panelit pavarësisht obligimit të vet për të bashkëpunuar me Panelin dhe t’i ofrojë atij ndihmën e nevojshme, duke përfshirë lëshimin e dokumenteve relevante për ankesat sipas nenit 15 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12; dosja nuk i është dorëzuar si duhet EULEX-it; apo UNMIK-u ka dështuar ta marrë dosjen nga kujdestari aktual. Paneli tashmë ka theksuar se nuk ka arsye të dyshojë në qëllimin e mirë të UNMIK-ut për kërkimin dhe sigurimin e dosjes së plotë hetimore për shqyrtimin e tij. Megjithatë, Paneli konsideron se cilido nga këto sqarime potenciale të jetë i zbatueshëm, tregon një dështim, që drejtpërdrejt i atribuohet UNMIK-ut kur ka ushtruar funksionet e veta ekzekutive apo në kapacitetin e tij të tanishëm”. Shih PKDNJ, *B.A.*, lënda nr. 52/09, përmendur në § 61 më lart, në §§ 71-75.

Dosje jo e plotë hetimore – pesha e dëshmisë

69. Në rastin *S.P. dhe V.G.J.*, ku UNMIK-u ishte në gjendje t'i ofrojë Panelit vetëm një dosje jo të plotë hetimore lidhur me hetimin për zhdukjen dhe vdekjen e viktimës, PSSP-ja argumentoi se mungesa e informatave mund të ketë qenë për shkak të mungesës së bartjes së informatave të zyrat përkatëse apo nga mungesa e thjeshtë e hetimit". Për këtë arsye, PSSP-ja theksoi se, "UNMIK-u nuk është në pozitë të komentojë në mënyrë të përshtatshme bazueshmërinë e çështjes". Në përgjigje, Paneli theksoi "përmbajtja e kufizuar e dosjeve hetimore, në veçanti në dritë të argumentit të PSSP-së se, për këtë arsye, nuk është e mundshme të konstatohet nëse ishte dështim i UNMIK-ut për të kryer hetim efektiv për rastin e [viktimës], ngrit çështjet e peshës së dëshmisë. Në lidhje me këtë, Paneli i referohet qasjes së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe gjithashtu Komisionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (KDNJ) për çështjen. Rregull e përgjithshme është se i takon palës që pohon një fakt ta dëshmojë atë, por kjo nuk është një rregull rigjide". Shih PKDNJ, *S.P. dhe V.G.J.*, lënda nr. 06/09 & 55/09, mendimi i 6 qershorit të vitit 2013, §§ 64, 70.

"Pesha joproportionale"

70. Në rastin *Filipoviq*, ku UNMIK-u ishte në gjendje t'i ofrojë Panelit vetëm një dosje jo të plotë hetimore lidhur me hetimin për zhdukjen dhe vdekjen e viktimës, PSSP-ja argumentoi se hetimi ishte në pajtim me standardet për një hetim efektiv siç parashihet me nenin 2 të KEDNJ-së, veçanërisht kur merren parasysh rrethanat që mbizotëronin në Kosovë në situatën pas konfliktit. PSSP-ja theksoi se në KEDNJ thuhet – në një situatë të ngjashme nga ajo e konfliktit të Bosnjës- se konsideratë e duhur duhet dhënë vështirësive të pandara në situatat pas konfliktit, dhe problemeve që kufizojnë aftësinë e autoriteteve hetimore për hetimin e rasteve të tilla. Sipas mendimit të PSSP-së, UNMIK-u hasi në një situatë të ngjashme me atë në Bosnjë. Paneli theksoi se "në përgjigje të vërejtjes së PSSP-së se neni 2 duhet të interpretohet në një mënyrë që nuk ngarkon barrë të papërballueshme apo joproportionale mbi autoritetet sa i përket kontekstit të aktiviteteve policore apo atij të prioriteteve dhe burimeve, Paneli e merr parasysh se Gjykata Evropiane ka vendosur se çfarë arrin në barrë të papërballueshme dhe/apo joproportionale duhet të matet nga faktet dhe kontekstet shumë të veçanta dhe konsideratë e duhur duhet kushtuar vështirësive të pandashme me situatat pas konfliktit, dhe problemeve që kufizojnë aftësinë e autoriteteve hetimore për të hetuar rastet e tilla". Shih PKDNJ, *Filipoviq*, lënda nr. 92/09, mendimi i 25 prillit të vitit 2013, §§ 45-46, 74.

Datë e paqartë e rrëmbimit

71. Në rastin *P.S.*, ku UNMIK-u ishte në gjendje t'i ofrojë Panelit vetëm një dosje jo të plotë hetimore lidhur me hetimin për zhdukjen dhe vdekjen e viktimës, PSSP-ja argumentoi se përpjekjet e Policisë së UNMIK-ut për të ndjekur pistat e hetimit të siguruara nga dëshmitarët ishin të pasuksesshme, për shkak të mungesës të informatave bindëse për fatin e viktimës, duke përfshirë në mënyrë specifike, mungesën e qartësisë rreth datës së zhdukjes së saj. Paneli nuk u pajtua, duke theksuar se "në rrethanat e këtij rasti, data e zhdukjes nuk është një fakt aq vendimtar që, nëse ishte gabim për disa ditë, do të mund të rrezikonte seriozisht hetimin. Qëllimi i hetimit ishte të zbulojë të vërtetën rreth ngjarjeve që çuan te zhdukja e [viktimës], të gjejë atë apo mbetjet e saj mortore dhe t'i identifikojë

autorët e mundshëm”. Shih PKDNJ, P.S. lënda nr. 48/09, mendimi i 31 tetorit të vitit 2013, §§ 60, 88-89.

Nuk është mbledhur asnjë mostër e ADN-së

72. Në rastin *Buleviq*, UNMIK-u ishte në gjendje t’i ofrojë Panelit vetëm një dosje jo të plotë hetimore lidhur me hetimin për zhdukjen e viktimës, dhe nuk mbledhi mostrat e ADN-së nga familja e viktimës. Paneli e vuri në pyetje efektivitetin e veprimeve të UNMIK-ut. “Në këtë drejtim, Paneli thekson se mbledhja e mostrave të ADN-së është vetvetiu një veprim esencial që siguron materialin e nevojshëm për ndonjë shqyrtim krahasues në të ardhmen dhe identifikimin e mundshëm të mbetjeve të gjetura mortore. Megjithatë, në këtë rast, e para, mostrat e tilla akoma nuk janë mbledhur, katërmbëdhjetë vjet pasi [viktima] pretendohet se është rrëmbyer, dhe, e dyta, nuk është ofruar sqarim nga autoritetet se pse kjo nuk ishte bërë. Pranohet gjerësisht se mënyra e vetme për të pasur identifikim të sigurt të mbetjeve mortore pas një periudhe të tillë të gjatë kohore do të ishte krahasimi i mostrave të materialit të ADN-së. Kështu, mbledhja e mostrave të mjaftueshme nga të afërmit e një personi të zhdukur bëhet imperativ, dhe pa këtë gjasat për të vërtetuar identitetin e mbetjeve mortore, nëse gjenden, janë shumë të pakta. Prandaj, meqë dështimi në vazhdim për të mbledhur mostrat e tilla rrezikon seriozisht mundësinë e identifikimit të mbetjeve mortore të [viktimës] (në rast se ato janë gjetur apo do të gjenden), Paneli konsideron se pjesa e parë e obligimit procedural sipas nenit 2 të KEDNJ-së nuk është plotësuar”. Shih PKDNJ *Buleviq*, lënda nr. 146/09, mendimi i 13 dhjetorit të vitit 2013, §§ 94-95.

Dëshmitarët u zhvendosën jashtë juridiksionit të Kosovës dhe nuk ishin intervistuar

73. Në rastin *Todorovski*, ku UNMIK-u ishte në gjendje t’i ofrojë Panelit vetëm një dosje jo të plotë hetimore lidhur me hetimin për zhdukjen dhe vdekjen e viktimës, Paneli diskutoi aspektet e veçanta që e bënë dosjen hetimore jo të plotë. Në mënyrë specifike, Paneli theksoi se, “Në raportin e njëjtë, hetuesi gjithashtu deklaroi se dy dëshmitarët tjerë nuk ishin intervistuar, pasi deri në kohën që Policia e UNMIK-ut provoi t’i kontaktojë, ata të dy ishin shpërngulur në Serbi dhe më nuk mund të kërkoheshin. E para, Paneli konsideron se kjo përpjekje për të kontaktuar dëshmitarët, katër vjet pas rrëmbimit, ishte padyshim e vonuar. E dyta, dosja duhet të ketë së paku një sqarim të shkurtër se si Policia e UNMIK-ut bëri përpjekje faktikisht t’i gjejë ata. Megjithëse hetuesit akoma ishin në gjendje të gjejnë dhe bisedojnë me njërin nga dëshmitarët, deklarata e tij kurrë nuk është regjistruar zyrtarisht. Sipas mendimit të Panelit, kjo mungesë e reagimit të shpejtë të Policisë së UNMIK-ut mund t’u ketë dërguar sinjalin autorëve që, autoritetet ose nuk ishin në gjendje apo nuk ishin të gatshme t’i hetojnë aktet e tilla kriminale. Një qëndrim i tillë i autoriteteve ndaj krimeve më të rënda në ndonjë shoqëri, dhe veçanërisht në rrethanat pas konfliktit, krijon pashmangshëm një kulturë të mosdëshkimit ndër kriminelët dhe mund të çojë vetëm në përkeqësim të situatës”.

74. Paneli gjithashtu theksoi, “Duke vlerësuar këtë hetim përkundrejt nevojës për të marrë hapa të arsyeshëm hetimorë dhe ndjekur pista të qarta hetimi për të siguruar dëshmi, Paneli e merr parasysh se një dosje hetimore e mbajtur në mënyrë të duhur, duhet t’i ketë të përfshira regjistrimet e të gjitha veprimeve hetimore dhe veçanërisht intervistat me

ankuesin, të dyshuarit dhe të gjithë dëshmitarët e mundshëm të rrëmbimit. Në të gjitha rastet, intervistat e tilla duhet të bëhen sa më shpejt që të jetë e mundshme dhe duhet të regjistrohen dhe ruhen në dosjen e rastit. Dështimi për të identifikuar, gjetur dhe intervistuar zyrtarisht personat të cilat ishin përmendur si të përfshirë në rrëmbim, përsëri rrezikon efektivitetin e hetimit”. Shih PKDNJ, *Todorovski* nr. 81/09, mendimi i 31 tetorit të vitit 2013, §§ 109-111.

75. Ngjashëm, në rastin *Buleviq*, Policia e UNMIK-ut nuk e kishte intervistuar familjen e viktimës dhe një dëshmitare të mundshme okular, të cilët të gjithë me sa duket e kishin braktisur Kosovën menjëherë pas zhdukjes së viktimës dhe tashmë ishin persona të zhvendosur në Serbi. Paneli theksoi se “[ai] vlerëson vështirësitë në të cilat UNMIK-u hasi gjatë fazës së parë të vendosjes së tij. Paneli thekson që rëndësia e duhur kushtuar çështjes së personave të zhdukur në Kosovë, nënkupton që UNMIK-u është dashur t’i marrë parasysh të dyja dimensionet humanitare dhe penale të situatës. Në veçanti, Paneli konsideron se rëndësia që u është kushtuar hetimeve penale dhe vështirësitë në Kosovë që kufizuan aftësinë e autoriteteve hetimore për t’i kryer hetimet e tilla, siç u përshkrua nga PSSP-ja, ishin vendimtare që UNMIK-u të krijojë nga fillimi një ambient të favorshëm për kryerjen e hetimeve kuptimplota. Kjo do të përfshinte krijimin e një sistemi ku do të hynin elementet e tilla, siç janë dhënia e përgjegjësisë së plotë për mbikëqyrjen dhe monitorimin e progresit në hetime, sigurimin e shqyrtimit të rregullt të gjendjes së hetimeve dhe një proces për dorëzim të duhur të rasteve ndërmjet nëpunësve apo njësisive të ndryshme të Policisë së UNMIK-ut. Një sistem i tillë gjithashtu duhet marrë parasysh nevojat për mbrojtje të viktimave dhe dëshmitarëve dhe gjithashtu të konsiderojë cenueshmërinë e veçantë të personave të zhvendosur në situatat pas konfliktit. Kështu, sipas mendimit të Panelit, ishte detyrë e UNMIK-ut ta kontaktojë familjen e viktimës, e jo që ata të kthehen në Kosovë, nga ku ishin larguar për arsye sigurie, për të provuar të zbulojnë se çfarë i kishte ndodhur me të afërmit e tyre apo hetimin”. Shih PKDNJ, *Buleviq*, nr. 146/09, përmendur në § 72 më lart, në §§ 83, 100.

Dosja jo e plotë hetimore – mbledhja e ADN-së vetëm një aspekt i hetimit efektiv

76. Në rastin *Todorovski*, ku hetimi për zhdukjen e viktimës kishte përfshirë mbledhjen e ADN-së, Paneli specifikoi se mbledhja e ADN-së është vetëm një aspekt i një hetimi efektiv. Paneli theksoi “se mbledhja e mostrave të ADN-së është vetvetiu një veprim esencial që siguron materialin e nevojshëm për çdo shqyrtim të ardhshëm krahasues dhe identifikim të mundshëm të mbetjeve mortore. Megjithatë, pasi në këtë rast nuk është bërë akoma një identifikim i tillë, Paneli do t’i kthehet hetimit të kryer nga Policia e UNMIK-ut me qëllim të identifikimit të autorëve dhe sjelljen e tyre para drejtësisë, që është elementi i dytë i obligimit procedural sipas nenit 2 të KEDNJ-së”. Shih PKDNJ, *Todorovski*, lënda nr. 81/09, mendimi i 31 tetorit të vitit 2013, § 107.
77. Ngjashëm, në rastin *GJ.LL.*, UNMIK-u ishte në gjendje t’i ofrojë Panelit vetëm një dosje jo të plotë hetimore lidhur me hetimin për zhdukjen dhe vdekjen e viktimës, por ofroi informata lidhur me punën e mjekësisë së saj ligjore në këtë rast. PSSP-ja sqaroi, “familjet e personave të zhdukur kanë të drejtë të dinë për fatin e personit”, e cila, sipas PSSP-së përfshinë të drejtën e tyre “për një identifikim të saktë të të gjithë trupave të gjetur deri më tani, siguruar nëse i afërmi i tyre është në mesin e të vdekurve, dhe gjithashtu, për

informata, nëse ka, për atë se ku është gjetur trupi dhe si është vranë personi, etj.” PSSP-ja vazhdoi se “[f]amilja gjithashtu ka të drejtë të varrosë trupin e të afërmit të vdekur, nëse dhe kur të kthehet”. Sipas PSSP-së, “aktivitetet kryesore të kërkuara për adresimin e [këtyre] aspekteve” janë puna e mjekësisë ligjore, duke përfshirë “kërkimin e varreve të supozuara, zhvarrimet, autopsitë, krahasimin e të dhënave ante dhe post mortem, testet e ADN-së, informimin e familjeve dhe kthimin e trupave dhe gjërave personale të gjetura te familjet”. Megjithatë, Paneli nuk u pajtua. “Paneli mirëpret një numër deklaratash të PSSP-së në lidhje me procesin e gjetjes dhe identifikimit të mbetjeve mortore të personave të zhdukur, dhe për të drejtën e të afërmeve në këtë drejtim. Megjithatë, Paneli nuk pajtohet plotësisht me pohimin se pjesa kryesore e punës në këtë drejtim varet nga veprimi i mjekësisë ligjore, siç paraqitet nga PSSP-ja. Në këtë rast të veçantë, pasi pothuaj nuk është kryer kurrfarë hetimi, duket të ketë pak hapësirë për punën e mjekësisë ligjore”. Shih PKDNJ, *GJ.Ll.* lënda nr. 88/09, mendimi i 21 nëntorit të vitit 2013, §§ 53, 109.

78. Në rastin e njëjtë, *GJ.Ll.*, duke sqaruar pse hetimet e mëtejme nuk ishin kryer, PSSP-ja kishte argumentuar se “veprimi [h]etimor nga UNMIK-u duket të ketë mbetur në zhvillim e sipër ... për shkak të mungesës së informatave apo pistave të hetimit që do të mundësonin hetim të mëtejme kuptimplotë dhe prioritizim ndaj rasteve tjera”. Paneli nuk pajtohet, duke theksuar “pothuajse çdo hetimi i mungojnë informata të rëndësishme në fazën fillestare. Qëllimi i çdo aktiviteti hetimor është gjetja e informatave për të plotësuar ato zbrazëti. Prandaj, mungesa e informatave nuk duhet të shfrytëzohet si argument për të mbrojtur mosveprimin nga autoritetet hetimore. Dosja, siç i është vënë në dispozicion Panelit, nuk tregon për një aktivitet të tillë. Kështu, duket se Policia e UNMIK-ut thjesht priti që informatat e tjera të dalin vetvetiu. Në këtë situatë, sipas mendimit të Panelit, pasiviteti i tillë i Policisë së UNMIK-ut ... mund të ketë çuar kah humbja e dëshmimeve potenciale”. Shih PKDNJ *GJ.Ll.* lënda nr. 88/09, përmendur në § 77 më lart, në § 123.

Dosje hetimore jo e plotë/jo e organizuar

79. Në rastin *Buleviq*, UNMIK-u ishte në gjendje t’i ofrojë Panelit vetëm një dosje jo të plotë hetimore lidhur me hetimin për zhdukjen dhe vdekjen e viktimës. PSSP-ja shprehu pakënaqësinë lidhur me mënyrën se si informata ishte paraqitur në dosjen hetimore, pasi pjesë informatash ishin gjetur në dokumente të ndryshme, të dorëzuara nga ankuesja apo të siguruar nga EULEX-i. Dosja me sa duket ishte përpiluar në data të ndryshme dhe shpesh pa referime, të cilat ndoshta do të kishin lejuar pamje të plotë të incidentit. Paneli theksoi se ndërsa ai e ndau plotësisht shqetësimin e PSSP-së lidhur me dosjen jo të organizuar, “Paneli, megjithatë, konstaton se duke marrë parasysh rrethanat e rastit aktual, një mungesë e tillë e strukturës dhe analizës së informatave të pakta në dispozicion në dosjen hetimore nuk ishte një shkak i dështimit të Policisë së UNMIK-ut për të hetuar çështjen, por mjaft qartë rezultat i këtij dështimi”. Shih PKDNJ, *Buleviq*, lënda nr. 146/09, përmendur në § 72 më lart, në §§ 83, 100.

Mungesa e koordinimit të hetimit

80. Në rastin *Stojkoviq*, UNMIK ishte në gjendje t’i ofrojë Panelit një dosje të plotë hetimore për zhdukjen dhe vdekjen e viktimës; megjithatë, hetimi ishte joefektiv për shkak të mungesës së koordinimit të hetimit nga prokurorët e UNMIK-ut dhe Policia e UNMIK-ut.

Paneli theksoi “dështimi i zgjatur për t’i lidhur hetimet e ndara për personin e zhdukur dhe trupin e paidentifikuar tregon se obligimi [për të kryer hetim efektiv] nuk përmbushet thjesht me krijimin e kornizës adekuate, por vetëm kur bëhet një sistem i koordinuar siç duhet që është në gjendje të kryejë hetim adekuat dhe efektiv në pajtim me nenin 2 të KEDNJ-së”. Shih PKDNJ, *Stojkoviq*, lënda nr. 87/09, mendimi i 14 dhjetorit të vitit 2013, § 164.

81. Në rastin e njëjtë, *Stojkoviq*, Paneli theksoi se vendimet kryesore prokuroriale duket të jenë marrë nga zëvendëskomisari i Policisë së UNMIK-ut. “Sipas mendimit të Panelit, një shqyrtim i duhur prokurorial i dosjes hetimore do të mund të rezultonte me veprime shtesë të rekomanduara, ashtu që rasti nuk do të kishte mbetur joaktiv me muaj”. Shih PKDNJ, *Stojkoviq*, lënda nr. 87/09, përmendur në § 80 më lart, në §§ 55, 160.

Efektiviteti i hetimit nga UNMIK-u lidhur me një person të zhdukur/vrarrë – dosja e plotë hetimore

82. Në rastin *Zdravkoviq*, ku UNMIK-u filloi hetimin për rrëmbimin e viktimës menjëherë dhe ndërmori të gjithë hapat hetimorë vendimtarë menjëherë pas incidentit, Paneli përfundoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 2, obligimi procedural, të KEDNJ-së. Në mënyrë specifike, Paneli trajtoi të dhënat hetimore dhe përcaktoi se “Policia e UNMIK-ut i kishte ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm për të kryer hetim efektiv siç përshkruhet me nenin 2, duke marrë parasysh realitetet e punës hetimore në Kosovë”. Shih PKDNJ, *Zdravkoviq*, lënda nr. 46/08, përmendur në § 56 më lart, në §§ 115, 119.
83. Ngjashëm, në rastin e njëjtë *Zdravkoviq*, kishte vonesë në identifikim të mbetjeve mortore, nga zhvarrimi i trupit në vitin 2003 deri tek identifikimi përfundimtar në vitin 2007, e cila pranohet nga PSSP-ja. Megjithatë, sipas PSSP-së, kjo vonesë ishte për shkakun e vështirësive që i përkisnin gërmimit të varrezave masive ku numri i personave është i madh, dhe kërkon ndarje dhe ribashkim të kujdesshëm të mbetjeve mortore dhe gjërave të identifikimit, dhe gjithashtu “nevojës për të përfunduar autopsitë e plota për çdo individ për t’u identifikuar”. PSSP-ja theksoi se, “Policia e UNMIK-ut në fakt mori të gjitha masat e nevojshme hetimore urgjente në fazat më të hershme të incidentit dhe vazhdoi me kujdes dhe pavarësi të gjitha kërkimet, ndërsa vepronte në rrethana të jashtëzakonshme si ato që janë tani në veriun e Kosovës”. Paneli e pranoi këtë argument, duke theksuar, “Paneli është i vetëdijshëm se proceset e zhvarrimit dhe identifikimit të mbetjeve mortore në kontekst të Kosovës së pas konfliktit merrnin veçanërisht shumë kohë, pasi një numër i konsiderueshëm i rasteve lidhur me personat e zhdukur trajtoheshin njëherësh nga UNMIK-u gjatë kësaj periudhe. Për procedurat e tilla, dhe veçanërisht identifikimet e bazuara në ADN, të miratuara në Kosovë prej vitit 2003, UNMIK-u duhej të mbështetej në bashkëpunimin teknik të institucioneve të jashtme, kryesisht KNPZH-ja. Për këtë arsye, Paneli nuk e konsideron vonesën e tillë të paarsyeshme. Paneli gjithashtu thekson se, duke pasur parasysh rrethanat e rastit, vonesa në identifikim nuk mund të konsiderohet se e ka dëmtuar më tutje hetimin dhe aftësinë e tij për t’i sjellë autorët para drejtësisë”. Shih PKDNJ, *Zdravkoviq*, lënda nr. 46/08, përmendur në § 56 më lart, në §§ 88-90, 122.

Shqyrtimi publik

84. Në rastin *Zdravković*, kishte një debat ndërmjet ankueses dhe UNMIK-ut për atë nëse ankueses i ishte dhënë informatë e mjaftueshme lidhur me progresin e hetimit të Policisë së UNMIK-ut për rrëmbimin e viktimës. Pas vënies në dukje se Policia e UNMIK-ut e kishte takuar në disa raste familjen e ankueses për të mbledhur informata me qëllim të çuarjes më tutje të hetimit, Paneli rikujtoi se KEDNJ-ja kishte konsideruar se “ky aspekt i obligimit procedural nuk u kërkon parashtruesve të ankesave të kenë qasje në dosjet policore, apo kopjet e të gjitha dokumenteve gjatë një hetimi në vazhdim, apo që ata të konsultohen apo informohen në çdo hap”. Paneli theksoi “pikëpamjen e ankueses se mundësia për marrjen e informatave ishte e kufizuar apo jo plotësisht e kënaqshme. Megjithatë, Paneli ka përshtypjen se informatat e kufizuara që i janë ofruar ankueses dhe familjes së saj ishin për shkak të mungesës së rezultateve konkrete, progresit substancial apo ndryshimit të statusit të hetimit. Për këto arsye, Paneli mendon se në rastin aktual parashtruesja nuk konsiderohet se ka qenë e përjashtuar nga procesi i hetimit në një shkallë të tillë që do të shkelte standardin minimal të nenit 2”. Shih PKDNJ, *Zdravković*, lënda nr. 46/08, përmendur në § 56 më lart, në § 125.

Arsyeshmëria e vonesës në hetim

85. Në rastin *R.A.*, i cili nuk ishte i lidhur me konfliktin, kishte një debat ndërmjet ankuesit dhe UNMIK-ut lidhur me atë nëse hetimi i Policisë së UNMIK-ut për vdekjen e dyshimtë të viktimës kishte qenë adekuat. Në veçanti, ankuesi pohoi se kishte vonesë të paarsyeshme në kryerjen e analizës toksikologjike pas autopsisë dhe se autoritetet hetimore nuk ndoqën të gjitha pistat e hetimit lidhur me vdekjen e nipit të tij. PSSP-ja argumentoi se fakti që analiza toksikologjike për vdekjen e viktimës nuk ishte kryer pas vdekjes së tij nga mjete të dyshimta, nuk përbën vonesë të tepërt sepse Kosovës i mungonte një laborator funksional i toksikologjisë në atë kohë. Paneli u pajtua me PSSP-në duke theksuar, “[p]asi vlerësoi aktivitetin e zhvilluar nga hetuesit menjëherë pas incidentit, pamundësinë e kryerjes së analizës toksikologjike në Kosovë së paku deri në mars të vitit 2007, dhe gjithashtu pjesën e kufizuar të hetimit që bie nën juridiksionin e përkohshëm të Panelit, Paneli konsideron vonesat e lartpërmendura të mos jenë të tepërta në rrethanat e rastit”. Shih PKDNJ, *R.A.*, lënda nr. 41/09, mendimi i 13 dhjetorit të vitit 2013, §§ 60, 65-66.

8.2.2. Ndalimi i torturës, trajtimit jonjerëzor dhe degradues – neni 3 i KEDNJ-së

Mungesa e dosjes hetimore – mungesa e kontaktit me ankuesen

86. Në rastin *Joçiq*, i cili ka të bëjë me pretendimin e ankueses se UNMIK-u nuk kreu hetim efektiv për zhdukjen dhe vrasjen e birit të saj dhe gjithashtu nuk e informoi atë për statusin e hetimit, Paneli së pari trajtoi çështjen nëse qëndrimi dhe reagimet e autoriteteve të UNMIK-ut për zhdukjen e personit të pagjetur dhe kërkimit të informatave nga ankuesja lidhur me fatin e djalit të saj dhe hetimin penal, përbënte shkelje të obligimit sipas nenit 3 të KEDNJ-së, duke marrë parasysh realitetet në Kosovë në kohën relevante. Paneli theksoi afërsinë e ngushtë të lidhjeve familjare ndërmjet ankueses dhe djalit të saj; veprimet që ankuesja i ka ndërmarrë për të provuar të marrë informata rreth tij; mungesa e kontaktit që Policia dhe prokurorët e UNMIK-ut e kishin me ankuesen; dhe vonesa e pasqaruar prej afërsisht tetë vjetësh mes gjetjes së mbetjeve mortore të viktimës dhe kohës kur ankuesja ishte informuar për identifikimin pozitiv të atyre mbetjeve.

87. Panel vazhdoi, duke theksuar që “Duke nxjerrë konkluzione nga dështimi i UNMIK-ut që t’i dorëzojë dokumentet hetimore apo të ofrojë sqarim tjetër bindës për mungesën e kontaktit të plotë me ankuesen, apo informatave rreth hetimit penal për zhdukjen dhe vrasjen e [viktimit], Paneli konsideron që kjo situatë, e cila vazhdoi në periudhën e juridiksionit të përkohshëm të Panelit, shkaktoi pasiguri të madhe për fatin e djalit të ankueses si dhe gjendjen e hetimit...Paneli konkludon që ankuesja përjetoi shqetësim të rëndë dhe dhimbje për një periudhë kohore të zgjatur dhe të vazhdueshme, nga mënyra se si autoritetet e UNMIK-ut e kanë trajtuar ankesën e saj dhe si rezultat ia kanë bërë asaj të pamundshme të zbulojë se çfarë i ka ndodhur djalit të saj...Paneli përfundon që, me sjelljen e vet, UNMIK-u i ka kontribuar shqetësimin dhe vuajtjes mentale të ankueses, duke shkelur nenin 3 të KEDNJ-së”. Shih PKDNJ, *Joçiq*, lënda nr. 34/09, mendimi i 23 prillit të vitit 2013 §§ 117-125.

8.2.3. E drejta për vendim gjyqësor brenda kohës së arsyeshme-neni 6 § 1 i KEDNJ-së

Njoftim i vonuar i gjykimit

88. Në rastin *Manohin*, ankuesi pohoi se vonesa e Gjykatës Komunale të Prishtinës për njoftim për vendimin e vet shkeli të drejtat e tij për një vendim gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme. PSSP-ja argumentoi se UNMIK-u nuk kishte faj pasi ankuesi nuk e informoi gjykatën se ai e kishte ndërprerë përfaqësimin nga ish-avokati i tij. PSSP-ja deklaroi “duke marrë parasysh heshtjen e të dyve, ankuesit dhe përfaqësuesit të tij të autorizuar ligjor, nuk është e qartë se si dhe nga kush tjetër është dashur t’i jepen Gjykatës Komunale të Prishtinës detajet e sakta të kontaktit të ankuesit, për të qenë në gjendje për ta informuar atë me ftesat për gjyq dhe vendimin e lartpërmendur”. Paneli u pajtua, duke theksuar, “në një rrethanë të tillë, ku ankuesi e diti se ai po e humbiste përfaqësimin e tij ligjor, ishte së paku pjesërisht përgjegjësi e tij të informojë Gjykatën Komunale të Prishtinës se kush, nëse kishte ndonjë, do të përfaqësonte atë në të ardhmen dhe në çfarë adrese duhet t’ia dërgojë ftesat e veta për gjyq dhe vendimet pasuese. Prandaj, Paneli konsideron se dështimi i ankuesit që t’i ofrojë Gjykatës Komunale të Prishtinës atë informatë lidhur me çështjen, në fakt substancialisht i kontribuoi vonesës në marrjen e vendimit nga ana e tij. Prandaj, Paneli nuk gjeti se kishte shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së”. Shih PKDNJ *Manohin*, lënda nr. 27/09, mendimi i 2 gushtit të vitit 2013, §§ 22, 25-26.

8.2.4. E drejta për mbrojtje të pronës –e drejta për qasje në gjyq–neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe neni 6 i KEDNJ-së–e drejta për kompensim efektiv–neni 13 i KEDNJ-së

Asnjë veprim nga UNMIK-u në procesin gjyqësor për atësi

89. Në rastin *Laliq*, ankuesja argumentoi se procedurat gjyqësore për të përcaktuar atësinë për fëmijën e saj kishin mbetur në zhvillim e sipër prej qershorit të vitit 1999, kur UNMIK-u po ushtronte përgjegjësinë për administrimin e drejtësisë në Kosovë. PSSP-ja argumentoi se UNMIK-u nuk i kishte përgjegjësitë lidhur me sistemin gjyqësor në Kosovë para vendosjes së tij. Paneli theksoi se “megjithëse është me siguri e vërtetë se UNMIK-u nuk ishte i pranishëm në Kosovë në vitin 1998 – koha kur ishte urdhëruar një rigjykim – është

gjithashtu e vërtetë se ai u bë përgjegjës për administratën e përkohshme në Kosovë, duke përfshirë administrimin e drejtësisë prej 10 qershorit të vitit 1999. Paneli gjithashtu konsideron se, në pajtim me funksionet e veta ekzekutive dhe obligimet për të drejtat e njeriut, është legjitime të pritët se përpjekjet e UNMIK-ut drejt rivendosjes së sundimit të ligjit dhe organizimit të drejtësisë në Kosovë, duhet gjithashtu t'i detyrojë politikatat që sigurojnë realizimin e garancive për gjykim të drejtë, duke përfshirë të drejtën për qasje në gjyq, për ata që kishin kërkesa gjyqësore në zhvillim e sipër në kohën e arritjes së UNMIK-ut". Meqë UNMIK nuk dha ndonjë sqarim se, pse kërkesa e ankueses nuk ishte proceduar nga gjyqet dhe as që dha një sqarim nëse ishte krijuar ndonjë politikë nga UNMIK-u për një sistem tranzicional, për të siguruar trajtimin e lëndëve tanimë në zhvillim e sipër në gjyqet e Kosovës nga periudha para arritjes së tij, Paneli gjeti se e drejta për qasje në gjyq siç parashihet me nenin 6 të KEDNJ-së është shkelur. Shih PKDNJ, *Laliq*, mendimi i 14 marsit të vitit 2013, lënda nr. 31/08, §§ 45, 47-49.

8.2.5. E drejta për shfrytëzim të patrazuar të pronave-neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

Lidhja organizative ndërmjet UNMIK-ut dhe Misionit të OSBE-së në Kosovë

90. Në rastin *Rajoviq*, ku Misioni i OSBE-së në Kosovë (OMiK) zuri pronën e ankuesit ndërmjet 1 marsit 2000 dhe 1 nëntorit 2007, Paneli gjeti se sapo UNMIK-u ishte njoftuar për çështjen e pronësisë, e kishte për detyrë të rishikojë dhe, nëse është e nevojshme, të korrigjojë natyrën e zotërimit nga OMiK, për shkak të përfshirjes së OMiK-ut në kornizën administrative të UNMIK-ut, në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999). Prandaj, dështimi i UNMIK-ut që të ndërmarrë ndonjë veprim korrigjues lidhur me kërkesën, sikur hyrja në kontratë për marrje me qira përbënte ndërhyrje të paligjshme nga UNMIK-u që arrinte në shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së për sa i përket zënies së paligjshme të objekteve në Pejë nga ana e OMiK-ut. Shih PKDNJ, *Rajoviq*, lënda nr. 308/09, mendimi i 6 qershorit të vitit 2013, §§ 39-40.

9. Komente dhe rekomandime përfundimtare të Panelit

91. Në vitin 2013, Paneli miratoi 53 mendime mbi bazueshmërinë ku gjeti shkelje të të drejtave të njeriut për të cilat ishte përgjegjës UNMIK-u. Në secilin nga këto raste, Paneli konstatoi se është e nevojshme ndonjë formë e dëmshpërblimit. Këtë vit, si në dhjetë vjetët e kaluara, Paneli e kishte disi të vështirë të përcaktojë se çfarë rekomandimesh duhet të japë në situatën ku UNMIK-u nuk është më në gjendje të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në vendimet që merren në Kosovë. Siç është theksuar më parë, UNMIK-u nuk mund të ndryshojë më legjislacionin nëse është e nevojshme (apo në çdo rast, madje edhe nëse ndryshohet legjislacioni relevant, ai nuk mundet që të sigurojë më tutje zbatimin e tij), dhe as që mundet t'i urdhërojë autoritetet e Kosovës që t'i rregullojnë të metat e tjera të identifikuara nga Paneli. Kjo situatë i kërkonte Panelit të jetë në dijeni për kufizimet e tilla ndërsa bënte rekomandime që do të kishin ndikim përfutues për gjendjen e të drejtave të njeriut të ankuesve të prekur.
92. Në 71 prej 72 rasteve të PZHV-e (të përmendura në § 44 më lart), Paneli gjeti se UNMIK-u kishte bërë shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së, në mënyrë specifike për shkak të dështimit për

të kryer një hetim efektiv për zhdukjen dhe rrëmbimin dhe/apo vrasjen e të afërmeve të ngushtë të ankuesve. Në këto raste, Paneli mori një qëndrim më të gjerë për dëmshpërblimet dhe rekomandoi që UNMIK-u të marrë siguri nga EULEX-i se hetimet do të vazhdonin në pajtim me kërkesat e nenit 2, se rrethanat që ndërlidhen me zhdukjen dhe vrasjen e viktimave do të sqarohen dhe autorët do të sillen para drejtësisë; ankuesi dhe/apo të afërmit e tjerë duhet të informohen për procedurat e tilla dhe dokumentet relevante duhet t'u zbulohen atyre, sipas nevojës. Përveç kësaj, Paneli i rekomandoi UNMIK-ut që të pranojë publikisht, brenda një kohe të arsyeshme, përgjegjësinë për sa i përket dështimit të tij që të hetojë në mënyrë adekuate zhdukjen dhe vrasjen e viktimave dhe t'u kërkojë falje publike ankuesve dhe familjeve të tyre në lidhje me këtë. Paneli gjithashtu rekomandoi që UNMIK-u t'i paguajë kompensim adekuat ankuesit për dëmin e shkaktuar moral për shkak të dështimit të UNMIK-ut që të kryejë hetim efektiv.

93. Përveç kësaj, Paneli rekomandoi që UNMIK-u të ndërmarrë hapa të nevojshëm, përmes organizmave të tjerë të afërt me OKB-në që veprojnë në Kosovë, organeve lokale dhe organizatave joqeveritare, për krijimin e një programi të plotë dhe gjithëpërfshirës dëmshpërblimi, duke përfshirë kthimin e kompensimit, rehabilitimin, përmbushjen dhe garancitë për mospërsëritje për viktimat nga të gjitha komunitetet që kanë qenë subjekt i shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut, të cilat ndodhën si pasojë e drejtpërdrejtë e konfliktit të Kosovës dhe gjatë tij. Në fund, Paneli rekomandoi që UNMIK-u të ndërmarrë hapa të nevojshëm para organeve kompetente të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së, që të ndajë burime adekuate njerëzore dhe financiare për të siguruar që standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut mbështeten në çdo kohë nga OKB-ja, duke përfshirë kohën kur kryhen funksione administrative dhe ekzekutive mbi një territor, dhe të sigurojë monitorim efektiv dhe të pavarur. Kështu, për herë të parë Paneli dha rekomandime që i kërkonin UNMIK-ut të kërkojë përgjigje sistimore për shkeljet e të drejtave të njeriut. Paneli shpreson për një reagim të duhur të UNMIK-ut ndaj këtyre rekomandimeve.
94. Në 53 raste, Paneli gjithashtu gjeti se UNMIK-u kishte bërë shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së (përmendur në §§ 46-51 më lart). Në mënyrë specifike, Paneli gjeti se dështimi i UNMIK-ut për të komunikuar me ankuesit dhe familjet e tyre lidhur me gjendjen e hetimeve të veta për zhdukjen, rrëmbimin dhe/apo vrasjen e të afërmeve të tyre u shkaktoi ankuesve dhe familjeve të tyre shqetësim të rëndë në kundërshtim me të drejtën për të qenë i lirë nga trajtimi degradues. Prandaj, përveç rekomandimit të të gjitha dëmshpërblimeve lidhur me shkeljet e nenit 2 të KEDNJ-së, Paneli rekomandoi që UNMIK-u gjithashtu t'u paguajë kompensim adekuat ankuesve për dëmin moral në lidhje me shkeljet e nenit 3 të KEDNJ-së.
95. Në rastet e shkeljeve të dispozitave të tjera, sikur shkeljet e së drejtës në pronë të garantuar me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, Paneli rekomandoi kompensim për dëmin material dhe jomaterial për shkeljen (shih PKDNJ, *Rajoviq*, nr. 308/09, përmendur në § 90 më lart). Në disa raste tjera, Paneli pranoi se ai do të kishte rekomanduar veprime të caktuara konkrete për UNMIK-un që t'i ndërmarrë për të korrigjuar situatën, po të përjashtohej fakti se UNMIK-u nuk ishte më tutje në gjendje të ushtrojë mandatin e vet sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara nr. 1244, pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë nga autoritetet e Kosovës dhe zhvillimeve pasuese

në terren. Duke pranuar faktin se UNMIK-u nuk mundej më që vetë të marrë hapa të nevojshëm për të korrigjuar situatën, Paneli ka rekomanduar që UNMIK-u ta ndajë mendimin me aktorët relevantë për të shpejtuar veprimin e mëtejshëm. Paneli e shfrytëzoi këtë formulë në rastin *Laliq*, duke rekomanduar që UNMIK-u “duhet bërë përpjekje, me të gjitha mjetet diplomatike në dispozicion të tij *vis-à-vis* autoriteteve të Kosovës, të marrë siguri që çështja gjyqësore e paraqitur nga ankuesja do të trajtohet siç duhet”. Shih PKDNJ, *Laliq*, nr. 31/08, përmendur në § 89 më lart.

96. Në çdo ankesë deri më tani në të cilën Paneli ka gjetur shkelje, Paneli ka rekomanduar që UNMIK-u të marrë masa të menjëhershme dhe efektive për t’izbatuar rekomandimet e veta dhe t’i informojë ankuesin dhe Panelin rreth zhvillimeve të mëtejme për rastin.

10. Reagimet e UNMIK-ut ndaj rekomandimeve të Panelit

97. Paneli thekson se neni 17.3 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 siguron që PSSP-ja të ketë autoritetin ekskluziv dhe lirinë e veprimit për të vendosur nëse do të veprojë në lidhje me gjetjet e Panelit, ndërsa neni 17.4 kërkon që vendimet e PSSP-së “të publikohen shpejt në anglisht, shqip dhe serbisht në një mënyrë që do të sigurojë përhapje dhe qasshmëri të gjerë”. Që nga viti 2010, 88 reagime në 124 mendime të miratuara nga Paneli janë vendosur në faqen e internetit të Panelit. Paneli është i inkurajuar të theksojë se UNMIK-u ka bërë përpjekje të publikojë më shumë reagime në mendimet e Panelit sesa në vitet e mëparshme. Në raportet vjetore të vitit 2011 dhe 2012, Paneli ka shprehur shqetësimin e vet ndaj mungesës së reagimit publik të UNMIK-ut në rekomandimet e Panelit, dhe në këtë Raport vjetor, Paneli thekson se UNMIK-u e ka konsideruar qartë prioritet adresimin e kësaj pune të pakryer. Megjithatë, natyra e reagimeve të UNMIK-ut, kombinuar me dështimin e UNMIK-ut që të arrijë ndonjë korrigjim apo përfitim praktik për ankuesit, mund të sugjerojë një mungesë të angazhimit të PSSP-së lidhur me Panelin dhe procesin e tij.
98. Sa i përket përmbajtjes së reagimeve të PSSP-së, në reagimin e tij ndaj njërit nga mendimet e Panelit për PZHV-të, *Paviq*, nr. 98/09 mendimi i 26 prillit të vitit 2013, PSSP-ja deklaroi se ai do të vazhdojë t’i kërkojë EULEX-it dhe autoriteteve tjera kompetente që t’i ndërmarrin të gjithë hapat për të siguruar që hetimet penale për zhdukjen dhe vrasjen e anëtarit të familjes së ankueses do të vazhdojnë dhe se autorët do të sillen para drejtësisë. Paneli e kupton se PSSP-ja ia ka dërguar një letër EULEX-it në lidhje me këtë rast, dhe në shumicën e rasteve të tjera për PZHV-të, duke u kërkuar atyre të vazhdojnë me hetimet. Në një aspekt pozitiv, Paneli ka kënaqësinë të raportoje se në vitin 2013, EULEX-i krijoi në Grup veprues, të udhëhequr nga një prokuror ndërkombëtar, i cili i trajton këto hetime të papërfunduara për PZHV-të dhe është i ngarkuar t’u japë rekomandime prokurorëve të EULEX-it dhe policisë rreth asaj se si të procedojnë. Megjithatë, deri në kohën e përpilimit të këtij raporti, Paneli nuk është në dijeni për ndonjë rezultat të prekshëm që është arritur nga Grupi veprues i EULEX-it.
99. Për sa i përket rekomandimit të Panelit që PSSP-ja t’u kërkojë falje publike ankuesve dhe familjeve të tyre për hetimin joefektiv, PSSP-ja deri tani u ka dërguar një letër shumë ankuesve, në të cilën thekson “Unë shpreh keqardhje të thellë që mungoi hetimi efektiv për rrëmbimin dhe vdekjen e [të dashurit] tuaj, e cila u ka shkaktuar juve shqetësim dhe

vuajtje mentale shtesë”. Paneli konsideron se, e para, nëse letra e PSSP-së përfshinte deklarata të rëndësishme për të ndërmarrë veprim korrigjues për të provuar për të përmirësuar vuajtjen e ankuesit, atëherë kjo do të mund të përbente një kërkim falje kuptimplotë. E dyta, në çdo rast, sipas mendimit të Panelit, kjo nuk përbën një kërkim falje publike.³⁰

100. Për sa i përket rekomandimit të Panelit që PSSP-ja të ndërmarrë hapa të duhur për të krijuar një program të plotë dhe gjithëpërfshirës dëmshpërblimi, duke përfshirë kthimin e kompensimit, rehabilitimin, përmeshjen dhe garancitë, PSSP-ja informon ankuesit se “Unë dua t’ua rikujtoj se aktet në fjalë kanë të bëjnë me aktivitetet e zhvilluara nga institucionet e krijuara nën administrimin e përkohshëm të Kosovës. Prandaj, nëse UNMIK-u do të kishte vazhduar të ketë kontroll mbi këto institucione sot, UNMIK-u do të ishte në pozitë t’u referohet rekomandimeve të Panelit për këto institucione për veprim përkatës”. Kjo është formula që UNMIK-u e ka zgjedhur që t’i informojë ankuesit se nuk do të ketë kompensim të paguar nga UNMIK-u për shkeljet e veta të të drejtave të njeriut. Amnesty International, në raportin e vet (shih § 36 më lart), konsideron qasjen e PSSP-së të papranueshme. “Ishte padyshim Policia e UNMIK-ut, më parë se autoritetet e Kosovës, që ishte e ngarkuar me përgjegjësinë për hetimin e rasteve të personave të zhdukur. Obligimi për të siguruar dëmshpërblim për dështimin për ta bërë këtë prandaj duhet të bie mbi UNMIK-un”³¹. Në raport thuhet se kur Amnesty International e pyeti UNMIK-un për këtë pikë, duke i kërkuar UNMIK-ut që t’i paguajë dëmshpërblimet, PSSP-ja tha, “...është një fakt i pakundërshtueshëm se kapaciteti i UNMIK-ut për të paguar dëmet material nuk ekziston dhe [ajo] tani bie mbi autoritetet lokale të Kosovës që kanë marrë kontrollin ekskluziv mbi administratën publike në Kosovë”. Në përgjigje të kësaj, Amnesty International shkroi, “Amnesty International e konsideron këtë përgjigje...të përbëjë një përpjekje të pazakontë të UNMIK-ut për të mos pranuar përgjegjësinë e vet për shkeljet e shumë standardeve për të drejtat e njeriut, për të cilat ishte krijuar t’i mbështesë dhe respektojë”.

101. Paneli pajtohet me raportin e Amnesty International. Nuk është e qartë pse kapaciteti i UNMIK-ut për t’i paguar dëmet jomateriale ka ndonjë lidhje me autoritetet lokale që kanë marrë kontrollin ekskluziv mbi administratën publike në Kosovë. Meqë shkeljet e të drejtave të njeriut ishin bërë nga personeli i OKB-së, duhet të jetë përgjegjësi e OKB-së që të paguajë kompensim për këto shkelje. Madje edhe po të ishte e vërtetë-siç e ka informuar PSSP-ja Panelin në korrespondencën e mëparshme³² -se udhëzimet e Asamblesë aktuale të Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (AP e OKB-së) për kompensim nuk lejojnë pagesë për shkelje të të drejtave të njeriut, do të ishte akoma e mundshme që PSSP-ja të trajtojë këtë situatë në AP të OKB-së në një përpjekje

³⁰Në gazetën serbe *Vesti*, në një tregim lidhur me reagimin publik ndaj mendimit të Panelit në rastin S.C. (të përmendur në § 35 më lart), koordinatori i Asociacionit të Familjeve të të Rrëmbyerve dhe Zhdukurve në Kosovë dhe Metohi deklaroi, “Të gjithë anëtarët e familjeve të personave të rrëmbyer dhe të zhdukur janë të bindur se UNMIK-u nuk ka bërë absolutisht asgjë për të gjetur të dashurit e tyre. Nëse UNMIK-u kërkon falje, ne si qenie njerëzore do ta vlerësonim atë, por tragjedia jonë nuk mund të harrohet nga një kërkim falje. Kërkim falja e vetme është të hetohen krimet kundër të dashurve tanë.”

³¹*Trashëgimia e UNMIK-ut në Kosovë: Dështimi për t’u ofruar drejtësi dhe dëmshpërblim të afërmve të të rrëmbyerve*, Amnesty International, 2013, në dispozicion në <http://www.amnesty.org/en/library/info/EUR70/009/2013/en>.

³²Për diskutim të mëtejshëm për këtë pikë, ju lutemi shihni Raportin vjetor të PKDNJ-së për vitin 2012 § § 90-91.

për të korrigjuar këtë të metë. Në fakt, në reagimet e mëparshme ndaj mendimeve të Panelit, PSSP-ja kishte deklaruar “UNMIK-u do të vazhdojë të tërheqë vëmendjen e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për nevojën e rishikimit të rregullave të tanishme për kompensim, të cilat përjashtojnë pagesën e kompensimit për dëmin jomaterial”. Deri më tani, Paneli nuk është në dijeni për ndonjë përpjekje të bërë nga PSSP-ja që të tërheqë vëmendjen e AP të OKB-së për nevojën e rishqyrtimit të rregullave të kompensimit. Në përgjigjet më të fundit për ankuesit, PSSP-ja madje nuk e përmend AP të OKB-së, duke deklaruar se, “Unë jam i gatshëm të diskutoj krijimin e një mekanizmi për t’i trajtuar çështjet e tilla me autoritetet relevante në rrethana përkatëse”. Paneli nuk është në dijeni për diskutime të tilla.

102. Për sa i përket rekomandimit të Panelit që PSSP-ja të japë garanci për mospërsëritje, PSSP-ja vetëm deklaroi se, “UNMIK-u nuk kryen më funksione policore, duke përfshirë hetimet policore”. Prapë, Paneli nuk pajtohet: mbrojtja e qëndrimit se UNMIK-u nuk ka asnjë përgjegjësi lidhur me mospërsëritjen, apo lidhur me kompensimin e ankuesve e dëmton kredibilitetin e krejt detyrës.
103. Shumë nga ankuesit i janë drejtuar Sekretariatit të Panelit pas marrjes së mendimeve të tyre që rekomandojnë që OKB-ja t’i kompensojë ata për shkeljen e të drejtave të tyre të njeriut. Këta ankues, të inkurajuar se ata mund të marrin ca validitet për vuajtjet e tyre, e kanë pyetur Sekretariatit të Panelit se çfarë ata duhet të bëjnë, me qëllim që vërtet ta marrin këtë kompensim. Në këtë kohë, Sekretariati vetëm mund t’i informojë se ata duhet kërkuar më shumë informata nga PSSP-ja.
104. Paneli thekson se, pavarësisht nga procesi i gjatë i nxjerrjes së vendimeve mbi pranueshmërinë, mendimeve dhe rekomandimeve, UNMIK-u mbetet në parim i papërgjegjshëm për shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e tij. Siç ka theksuar Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës në raportin e fundit, “(t)ë nëntorit të vitit 2013, UNMIK-u nuk ka ofruar kompensim për viktimat për shkeljet e të drejtave të njeriut siç rekomandohet nga Paneli ...”³³. Ky përfundim ka ardhur më shumë nga qëndrimi PSSP-së në përgjigje të rekomandimeve të Panelit, sepse procesi siç është përcaktuar në fillim, i dha Panelit mundësinë që të sigurojë një mbikëqyrje reale mbi UNMIK-un në lidhje me të drejtat e njeriut. Paneli, i cili ishte themeluar për t’i ofruar mbikëqyrje dhe përgjegjësi UNMIK-ut, nuk është në gjendje të arrijë që ta kryejë këtë funksion pa UNMIK-un të bashkuar në projekt dhe pa përgjigje të tij në të njëjtën mënyrë. Paneli kërkon nga PSSP-ja që të angazhohet në mënyrë më proaktive për rekomandimet e Panelit *vis-à-vis* ankuesve në vitin që po vjen, me qëllim që ta bëjë procesin të dobishëm për ankuesit.

³³Shih APKE, Këshilli i Evropës, “Përgjegjësi e organizatave ndërkombëtare për shkeljet e të drejtave të njeriut”, Dok.13370 ,17 dhjetor 2013, § 59.

11. Shtojcat:

- Shtojca A: Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut e 23 marsit të vitit 2006
- Shtojca B: Udhëzimi Administrativ i UNMIK-ut nr. 2009/1, Implementimi i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut e 17 tetorit të vitit 2009
- Shtojca C: Tabela statistikore e PKDNJ-së
- Shtojca D: Vendimet dhe mendimet e PKDNJ-së të marra në vitin 2013
- Shtojca E: Ankesat e pranuar nga PKDNJ sipas vitit
- Shtojca F: Rastet e mbyllura të PKDNJ-së (Të papranueshme, apo mendime mbi bazueshmërinë) sipas vitit
- Shtojca G: Shkurtesat dhe akronimet

Shtojca A

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au
Kosovo

UNMIK/REG/2006/12
23 mars 2006

RREGULLORE NR. 2006/12**MBI THEMELIMIN E PANELIT KËSHILLDHËNËS PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke pasur parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Me qëllim të themelimit të Panelit këshilldhënës për të drejtat e njeriut, si organ i përkohshëm gjatë mandatit të UNMIK-ut, për shqyrtimin e shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut nga ana e UNMIK-ut,

Me anë të kësaj shpall Rregulloren në vijim:

KAPITULLI I: Themelimi dhe kompetencat e Panelit këshilldhënës mbi të drejtat e njeriutNeni 1Themelimi i Panelit këshilldhënës mbi të drejtat e njeriut

1.1 Me këtë themelohet Paneli këshilldhënës mbi të drejtat e njeriut (Paneli këshilldhënës)

1.2 Paneli këshilldhënës shqyrton ankesat e çdo personi apo grupit të personave të cilët pohojnë se janë viktima të shkeljes së të drejtave të njeriut nga UNMIK-u sikur që është dhënë në njërin apo në më shumë instrumentet vijuese:

(a) Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e datës 10 dhjetor 1948;

b) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të datës 4 nëntor 1950 bashkë me Protokollin e saj;

(c) Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike e datës 16 dhjetor 1966 bashkë me Protokollin e saj;

(d) Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e datës 16 dhjetor 1966;

(e) Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor e datës 21 dhjetor 1965;

(f) Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave e datës 17 dhjetor 1979;

(g) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degraduese e datës 17 dhjetor 1984 dhe

(h) Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve e datës 20 dhjetor 1989.

1.3 Pas përfundimit të shqyrtimit të një ankese, Paneli këshillëdhënës ia dërgon konkluzionet e veta Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm. Konkluzionet e Panelit këshillëdhënës, të cilat mund të përfshijnë rekomandime janë të natyrës këshillëdhënëse.

Neni 2

Kompetencat e përkohshme dhe territoriale

Paneli këshillëdhënës ka kompetenca në gjithë territorin e Kosovës dhe për ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e supozuara të të drejtave të njeriut që janë bërë pas datës 23 prill 2005 apo që kanë rrjedh nga faktet e paraqitura para kësaj date dhe që këto fakte rrisin në vazhdimësi shkeljen e të drejtave njerëzore.

Neni 3

Kriteret për pranimin e ankesës

3.1 Paneli këshillëdhënës mund të trajtojë një çështje vetëm pasi të ketë konkluduar se janë ndjekur të gjitha rrugët tjera të mundshme për shqyrtimin e shkeljes së supozuar dhe brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga data kur është marrë vendimi i formës së prerë.

3.2 Paneli këshillëdhënës nuk shqyrton ankesën që është:

(a) anonime ose

(b) kryesisht e njëjtë me një çështje që tanimë është shqyrtuar nga Paneli këshillëdhënës dhe nuk përmban informata të reja përkatëse.

3.3 Paneli këshillëdhënës shpall si të papranueshme çdo ankesë të cilën e konsideron se nuk është në përputhshmëri me të drejtat e njeriut, të përcaktuara në një apo në më shumë instrumente të përmendura në nenin 1.2 lart dhe e konsideron si të pabazë ose shpërdorim i së drejtës së ankesës.

KAPITULLI 2: Përbërja dhe statusi i Paneli këshillëdhënës mbi të drejtat e njeriut

Neni 4 Selia dhe përbërja

4.1 Paneli këshillëdhënës e ka selinë në Prishtinë.

4.2 Paneli këshillëdhënës përbëhet prej tre anëtarëve nga të cilët njëri emërohet kryesues. Së paku një anëtar i Panelit këshillëdhënës duhet të jetë femër.

4.3 Anëtarët e Panelit këshillëdhënës janë juristë ndërkombëtarë me karakter të lartë moral, paanshmëri dhe integritet, të dëshmuar si ekspertë në fushën e të drejtave të njeriut, në veçanti në sistemin evropian.

Neni 5 Emërimi i anëtarëve

5.1 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm emëron anëtarët e Panelit këshillëdhënës pas propozimit të bërë nga Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

5.2 Anëtarët emërohen me mandat dy (2) vjeçar³⁴. Emërimi mund të vazhdohet edhe për një mandat tjetër dyvjeçar (2).

Neni 6 Dhënia e betimit solemn

Me rastin e emërimit, çdo anëtar i Panelit këshillëdhënës e nënshkruan deklaratën në vijim para Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm ose para personit të caktuar nga ai:

“Solemnisht deklaroj se:

“Do t’i përmbahem ligjit gjatë gjithë kohës së ushtrimit të funksioneve në postin tim dhe do të veproj në pajtim me standardet më të larta profesionale e respektin më të lartë ndaj dinjitetit të postit tim dhe detyrave që më janë besuar.

Në ushtrimin e funksioneve të postit tim gjithmonë do të mbështes standardet më të larta të pranuar ndërkombëtarisht mbi të drejtat e njeriut, përfshirë ato të paraqitura në parimet e Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut, në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut bashkë me Protokollet e saj, në

³⁴Qëndrimi në detyrë i anëtarëve të Panelit është zvogëluar në një vit, me përtëritje, sipas Rregullores së UNMIK-ut nr.2007/3 të 12 janarit të vitit 2007.

Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike bashkë me Protokollet e saj, në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, në Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, në Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të tjera Mízore, Çnjerëzore apo Degraduese dhe në Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve”.

Neni 7

Imuniteti dhe pacenueshmëria

7.1 Zyrat e shfrytëzuara nga Paneli këshillëdhënës janë të pacenueshme. Arkivi, lëndët, dokumentet, komunikimet, prona, fondet dhe pasuritë e Panelit këshillëdhënës kudo që të vendosen dhe nga kushdo që të mbahen janë të pacenueshme dhe të mbrojtura nga bastisja, marrja, sekuestrimi, konfiskimi, shpronësimi ose nga çfarëdo forme tjetër e ndërhyrjes përmes veprimit ekzekutiv, administrativ, gjyqësor a legjislativ.

7.2 Anëtarët e Panelit këshillëdhënës kanë imunitet të njëjtë si personeli i UNMIK-ut sipas neneve 3.3 dhe 3.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/47 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë.

7.3 Sekretari i Përgjithshëm ka të drejtë dhe përgjegjësi t’ia heqë imunitetin e anëtarit të Panelit këshillëdhënës në çdo rast që, sipas mendimit të tij, imuniteti do të pengojë rrjedhat e drejtësisë dhe ai mund të hiqet pa cenuar interesat e UNMIK-ut.

Neni 8

Burimet financiare dhe njerëzore

Për funksionimin efikas të Panelit këshillëdhënës merren masat e duhura përmes sigurimit të burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore.

Neni 9

Sekretariati

Panelit këshillëdhënës ka sekretariatit me orar të plotë.

KAPITULLI 3: Procedura e punës së Panelit këshillëdhënës mbi të drejtat e njeriut

Neni 10

Parashtrimi i ankesave dhe përfaqësuesit sipas detyrës zyrtare

10.1 Ankesat i parashtrohen Panelit këshillëdhënës në formë të shkruar.

10.2 Ankesa mund të parashtrohet nga ankuesi ose në emër të tij nga anëtari i familjes, nga organizata joqeveritare ose nga sindikata.

10.3 Në mungesë të parashtrimit të ankesës sipas nenit 10.2, Paneli këshilldhënës mund të emërojë një person të përshtatshëm përfaqësues sipas detyrës zyrtare për të parashtruar ankesën dhe për të vepruar në emër të viktimës ose viktimave të dyshuara në procedurën e përcaktuar në këtë kapitull nëse Paneli këshilldhënës ka informacione të besueshme se është bërë shkelje e të drejtave të njeriut.

10.4 Me kërkesën e përfaqësuesit të caktuar sipas detyrës zyrtare, Paneli këshilldhënës mund të përfundojë procedurën sipas nenit 10.3 nëse viktima ose viktimat e dyshuara nuk dëshirojnë që të vazhdojë procedura ose nëse vazhdimi i procedurës nuk është me interes publik për ndonjë person tjetër.

10.5 Për parashtrimin e ankesës nuk parashihet kurrfarë pagese.

Neni 11 Parashtresat me shkrim

11.1 Ankesa paraqet të gjitha faktet e rëndësishme mbi të cilat bazohet shkelja e supozuar e të drejtave të njeriut. Ankesës mund t'i bashkëngjiten edhe dokumente të tjera si dëshmi.

11.2 Pas marrjes së ankesës Paneli këshilldhënës përcakton se a është ankesa e pranueshme. Nëse informacionet e dhëna me ankesën nuk mundësojnë që të bëhet një konstatim i tillë, Paneli këshilldhënës kërkon informacione shtesë nga ankuesi. Nëse Paneli këshilldhënës konstaton se ankesa është e papranueshme, ai merr vendim me të cilin refuzohet ankesa.

11.3 Kur Paneli këshilldhënës konstaton se ankesa është e pranueshme, ai ia referon ankesën Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në mënyrë që të merret një përgjigje në emër të UNMIK-ut lidhur me ankesën. Përgjigja e tillë i jepet Panelit këshilldhënës brenda njëzet (20) ditësh nga dita e pranimit të ankesës nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

11.4 Paneli mund të kërkojë nga ankuesi dhe UNMIK-u që të bëjnë parashtresa tjera me shkrim brenda afateve kohore që ai mund t'i caktojë nëse këto parashtresa janë në interes të drejtësisë.

Neni 12 Fshehtësia e komunikimeve

12.1 Komunikimet ndërmjet Panelit këshilldhënës dhe ankuesit ose personit që vepron në emër të tij janë të fshehta.

12.2 Fshehtësia e komunikimit siç paraqitet në nenin 12.1 zbatohet në tërësi kur ankuesi ose personi që vepron në emër të tij është në paraburgim.

Neni 13 Pjesëmarrja e një *Amicus Curiae* dhe e avokatit të popullit

13.1 Paneli këshilldhënës, kur është në interes të drejtësisë, mund të ftojë

(a) Një *amicus curiae* që të parashtrorë komentet me shkrim dhe

(b) Avokatin e popullit që të parashtrorjë komentet me shkrim nëse ai është duke u marrë me këtë çështje.

13.2 Parashtrësas me shkrim nga avokati i popullit do të jenë pa paragjykime mbi autorizimet, përgjegjësitë dhe obligimet e avokatit të popullit sipas ligjit në fuqi.

Neni 14 Seancat verbale

Kur është në interes të drejtësisë Paneli këshillëdhënës mban seanca verbale.

Neni 15 Kërkesat për paraqitjen e personave ose për parashtrimin e dokumenteve

15.1 Paneli këshillëdhënës mund të kërkojë paraqitjen e çdo personi, përfshirë edhe personelin e UNMIK-ut, ose parashtrimin e çdo dokumenti, përfshirë dosjet dhe dokumentet që i posedon UNMIK-u, të cilat mund të jenë të rëndësishme për ankesën.

15.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm bashkëpunon me Panelin këshillëdhënës dhe i ofron atij ndihmën e nevojshme gjatë ushtrimit të pushtetit dhe kompetencave të tij në mënyrë të veçantë për lëshimin e dokumenteve dhe informatave që janë të rëndësishme për ankesën..

15.3 Kërkesat për paraqitjen e personelit të UNMIK-ut ose për parashtrimin e dokumenteve të Kombeve të Bashkuara i bëhen Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm. Gjatë marrjes së vendimit për t'iu përgjigjur këtyre kërkesave Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm merr parasysh interesin e drejtësisë, promovimin e të drejtave të njeriut dhe interesat e përgjithshme të UNMIK-ut e të Kombeve të Bashkuara.

Neni 16 Seancat publike dhe qasja në dokumentet e deponuara në Panelin këshillëdhënës

16.1 Seancat e Panelit këshillëdhënës janë publike përveç në rastet e jashtëzakonshme kur Paneli këshillëdhënës vendos ndryshe.

16.2 Pas miratimit nga Paneli këshillëdhënës, dokumentet e deponuara në Panelin këshillëdhënës për të drejtat e njeriut mund t'i vihen në dispozicion çdo personi që ka interes të ligjshëm në çështjen pas paraqitjes së kërkesës me shkrim.

Neni 17 Konkludimet dhe rekomandimet e Panelit këshillëdhënës

17.1 Paneli këshillëdhënës sjell konkludimet mbi atë se a ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut dhe, kur është e nevojshme, bën rekomandime. Këto konkludime dhe çdo rekomandim i Panelit këshillëdhënës i parashtrohen Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

17.2 Konkludimet dhe rekomandimet e Panelit këshillëdhënës botohen me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në mënyrën që siguron shpërndarje të gjerë dhe qasje në to.

17.3 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm ushtron pushtetin dhe diskrecionin ekskluziv për të vendosur se a duhet vepruar sipas konkludimeve të Panelit këshillëdhënës.

17.4 Vendimet e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm botohen me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në mënyrën që siguron shpërndarje të gjerë dhe qasje në to.

Neni 18
Rregullorja e punës

18.1 Paneli këshillëdhënës miraton rregulloren e punës për procedurat e veta. Rregullorja e punës mund t'i japë autorizime dhe përgjegjësi sekretariatit të Panelit këshillëdhënës.

18.2 Pas miratimit nga Paneli këshillëdhënës, rregullorja e punës publikohet me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe me qëllim të shpërndarjes së gjerë dhe qasjes në to.

KAPITULLI 4: Dispozitat përfundimtare

Neni 19
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të shpallë çdo udhëzim të nevojshëm administrativ për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 20
Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 21
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 23 mars 2006, përveç nenit 10 i cili hyn në fuqi më 23 prill 2006.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Shtojca B**UNITED NATIONS**

United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES

Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au
Kosovo

UNMIK/DIR/2009/1

17 tetor 2009

URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2009/1**PËR IMPLEMENTIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UR NR. 2006/12 MBI
THEMELIMIN E PANELIT KËSHILLËDHËNËS PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP),

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me nenin 19 të Rregullores nr. 2006/12 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), të datës 23 mars 2006 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2007/3, të datës 12 janar 2007 (Rregullorja),

Duke marrë parasysh Rregulloren e Punës të miratuar më 5 shkurt 2008 nga Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, në pajtim me nenin 18 të Rregullores,

Me qëllim të qartësimit të karakterit dhe rregullimit të procedurave të dëgjimeve publike të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, shqyrtimin e pranueshmërisë së ankesave nga ky Panel dhe caktimin e një afati kohor për paraqitjen e ankesave pranë këtij Paneli, Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, duke pasur parasysh kapacitetin e zvogëluar të UNMIK-ut që të ushtrojë autoritet ekzekutiv në mënyrë efektive në të gjitha fushat nga ku burojnë çështjet e ankesave për të drejtat e njeriut,

Me anë të kësaj nxjerr këtë Urdhëresë administrative,

Neni 1Dëgjimet publike

1.1 Dëgjimet publike të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (Paneli Këshillëdhënës) do të drejtohen në mënyrën dhe përbërjen që qartazi do të lënë të kuptohet se janë procedura joadversiale dhe që do t'ju përcillen të gjithë pjesëmarrësve si dhe opinionit të gjerë publik, duke përfshirë edhe mediat e pranishme, nëse prania e tyre lejohet nga Paneli Këshillëdhënës.

1.2 Gjatë dëgjimeve publike, ankuesve apo përfaqësuesve të tyre do t'ju lejohet të bëjnë deklaratat duke përmbledhur pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut, ashtu siç është paraqitur

në parashtrësën me shkrim pranë Panelit Këshillëdhënës. Gjatë dëgjimeve publike, Paneli Këshillëdhënës mund t'ju parashtrtojë pyetje palëve ose përfaqësuesve të tyre të cilat qartësojnë bazën faktike të ankesës, dhe që për Panelin Këshillëdhënës janë të nevojshme që në tërësi të vlerësojë pohimin për shkeljen e të drejtave të njeriut të paraqitur pranë tij.

1.3 Vendi dhe rregullimi i ulëseve për dëgjimet publike të drejtuara nga Paneli Këshillëdhënës janë në përputhje me natyrën joadversiale të procedurës.

Neni 2 Çështjet e pranueshmërisë

2.1 Në cilëndo fazë të procedurës së një ankese mbi të drejtat e njeriut të paraqitur pranë tij, Paneli Këshillëdhënës shqyrton të gjitha çështjet e pranueshmërisë së ankesës para se të shqyrtojë bazueshmërinë e rastit.

2.2 Çdo ankesë e cila është apo mund të jetë në të ardhmen çështje e procesit të ankesave të palës së tretë ose procedurave sipas nenit 7 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/47 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë, të datës 18 gusht 2000, do të konsiderohet e papranueshme për arsye se procesi i ankesave të palës së tretë të KB-së dhe procedura sipas nenit 7 të Rregullores nr. 2000/47 janë mjete në dispozicion sipas nenit 3.1 të Rregullores.

2.3 Komentet mbi bazueshmërinë e një pretendimi për shkelje të të drejtave të njeriut duhet dorëzuar vetëm pasi Paneli Këshillëdhënës të ketë përfunduar shqyrtimin dhe vendosur për pranueshmërinë e ankesës së tillë. Nëse çështjet e pranueshmërisë së një ankese adresohen në çfarëdo kohe pasi që Paneli Këshillëdhënës të ketë marrë një vendim mbi pranueshmërinë e ankesës dhe filluar shqyrtimet e veta të bazueshmërisë, Paneli Këshillëdhënës do të suspendojë shqyrtimet e veta mbi bazueshmërinë deri në njëkohë që pranueshmëria e ankesës të rivlerësohet plotësisht dhe vendoset përsëri.

2.4 Pas çdo vendimi të ri mbi pranueshmërinë e rastit, Paneli Këshillëdhënës vendimin e tillë të ri ia referon Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm me qëllim të marrjes së komenteve shtesë për ankesën.

Neni 3 Emërimi dhe dorëheqja e anëtarëve të Panelit

3.1 Kryetari i Gjykatës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut do të propozojë një numër të mjaftueshëm të kandidatëve të përshtatshëm për emërim sipas nenit 5 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2006/12, në pajtim me rregullat e zbatueshme të prokurimit të KB-së, pas marrjes së kërkesës nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Nëse UNMIK-u nuk merr asnjë propozim apo merr numër të pamjaftueshëm të propozimeve brenda një muaji kalendarik nga kërkesa e tillë, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të bëjë emërimin e nevojshëm pa propozimin e kërkuar dhe pas konsultimeve me organet relevante ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.

3.2 Nëse një apo më shumë anëtarë të Panelit Këshillëdhënës japin dorëheqje nga postet e tyre, Paneli nuk merr asnjë vendim derisa të bëhen emërimet e reja duke ia mundësuar Panelit të arrijë numrin e parashikuar të anëtarëve.

Neni 4

Publikimet e Panelit Këshillëdhënës

Të gjitha publikimet, njoftimet dhe komunikatat për shtyp të Panelit Këshillëdhënës bëhen përmes zyrës së zëdhënësit të UNMIK-ut dhe informimit publik, që e ndihmon Panelin Këshillëdhënës në njoftimet e tij zyrtare mbi të gjitha çështjet.

Neni 5

Data e prerë për parashtrimin e ankesave

Pavarësisht nga neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, asnjë ankesë dorëzuar Panelit Këshillëdhënës nuk do të jetë e pranueshme nëse pranohet nga Sekretariati i Panelit Këshillëdhënës më vonë se 31 mars 2010.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi më 17 tetor 2009 dhe është e zbatueshme për të gjitha ankesat e dorëzuara Panelit Këshillëdhënës, duke përfshirë edhe ato të cilat janë në pritje për t'u shqyrtuar nga Paneli Këshillëdhënës.

Lamberto Zannier

Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Shtojca C

Ngarkesa me lëndë e PKDNJ-së, Komunikatat & Vendimet (si më 31 dhjetor 2013)

| Numri i lëndëve | | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | Gjithsej |
|---------------------------------------|--------------------------|------|------|------|------|------|------|------|------|-------------------------|
| Të pranuar | | 3 | 12 | 69 | 353 | 90 | n/a | n/a | n/a | 527 |
| Të mbyllura | | 0 | 0 | 18 | 11 | 35 | 98 | 95 | 85 | 342 |
| Në zhvillim e sipër | | 3 | 15 | 66 | 408 | 463 | 365 | 270 | 185 | 185 |
| Vendimet sipas llojit | | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | Gjithsej |
| Gjithsej | | 0 | 0 | 32 | 26 | 84 | 213 | 270 | 90 | 715 |
| Vendimet mbi pranueshmërinë | | 0 | 0 | 28 | 22 | 56 | 164 | 238 | 10 | 518 |
| Vendimet për të pjesshme | | 0 | 0 | 2 | 0 | 1 | 0 | 0 | - | 3 |
| Heqja nga lista | | 0 | 0 | 0 | 3 | 5 | 2 | 6 | - | 16 |
| Mendimet mbi bazueshmërinë | | 0 | 0 | 1 | 0 | 22 | 46 | 23 | 78 | 170 |
| Mendimet e pjesshme mbi bazueshmërinë | | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | - | 1 |
| Kërkesat për rishikim dhe rihapje | | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 1 | 3 | 2 | 7 |
| Vendimet sipas gjetjeve | | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | |
| Vendimet | Të pranueshme | 0 | 0 | 11 | 2 | 16 | 63 | 112 | 2 | 206 |
| | Pjesërisht të pranueshme | 0 | 0 | 2 | 9 | 25 | 51 | 60 | 2 | 149³⁵ |
| | Të papranueshme | 0 | 0 | 17 | 8 | 10 | 50 | 66 | 6 | 157 |
| Mendimet:Shkelje | | 0 | 0 | 1 | 0 | 21 | 45 | 21 | 76 | 164 |
| Mendimet:Nuk ka shkelje | | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 1 | 2 | 3 | 8³⁶ |
| Kërkesat për rishqyrtim : | Të refuzuar | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 1 | 1 | 2 | 5 |
| | Të miratuar | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | - | 2 |

³⁵Tre nga to janë vendime “pjesërisht të pranueshme”.

³⁶Një nga to është mendim i pjesshëm mbi bazueshmërinë.

| | | | | | | | | | | |
|--|---|--|--|--|--|--|--|--|--|--|
| | a | | | | | | | | | |
|--|---|--|--|--|--|--|--|--|--|--|

Shtojca D

Vendimet dhe mendimet e PKDNJ-së të marra në vitin 2013

Vendimet plotësisht të pranueshme: 2 (2)

1. RAJOVIQ, Millorad, 308/09 –vendimi i 31 janarit të vitit 2013
2. MIRIQ, Svetislav, 342/09 –vendimi i 15 shkurtit të vitit 2013

Vendimet pjesërisht të pranueshme: 2 (2)

1. MILLADINOVIQ, Nebojsa, 331/09 –vendimi i 14 marsit të vitit 2013
2. KRASNIQI, Tomë, 08/10 –vendimi i 6 qershorit të vitit 2013

Vendimi mbi kërkesën për të rihapur procedurat: 1 (1)

1. TOMANOVIQ, Verica, 191/09 –vendimi i 7 qershorit të vitit 2013

Vendimet e papranueshme: 6 (6)

1. MILLOSAVLEVIQ, Gavriilo, 164/09 –vendimi i 31 janarit të vitit 2013
2. GRKOVIQ, Miroslav, 5/10 –vendimi i 15 shkurtit të vitit 2013
3. MALOKU, Shehide, 02/10 –vendimi i 14 marsit të vitit 2013
4. SIMONOVIQ, Snezhana, 257/09 –vendimi i 14 marsit të vitit 2013
5. JUGOBANKA (I), 57/10 –vendimi i 6 qershorit të vitit 2013
6. JUGOBANKA (II), 58/10 –vendimi i 6 qershorit të vitit 2013

Mendimet: Shkelje 53 (76)

1. KOSTIQ, Petra, 194/09 – mendimi i 31 janarit të vitit 2013
2. B.A., 52/09 –mendimi i 1 shkurtit të vitit 2013
3. T.P., 88/10 –mendimi i 15 shkurtit të vitit 2013
4. J.D., 44/09 –mendimi i 14 marsit të vitit 2013
5. BOGIÇEVIQ, Mirjana, 112/09 –mendimi i 14 marsit të vitit 2013
6. RISTANOVIQ, Sllavica, 123/09 –mendimi i 14 marsit të vitit 2013
7. NEDELKOVIQ, Sllavica, 268/09 –mendimi i 14 marsit të vitit 2013
8. VUKIÇEVIQ, Jagoda, 272/09 –mendimi i 14 marsit të vitit 2013
9. LALIQ, Marija, 31/08 –mendimi i 14 marsit të vitit 2013
10. JOÇIQ, Svetllana, 34/09 –mendimi i 23 prillit të vitit 2013
11. TOMANOVIQ, Dushan, KOKOVIQ -TOMANOVIQ, Jellena, dhe TOMANOVIQ, Verica, 248/09, 250/08, 251/09 –mendimi i 25 prillit të vitit 2013
12. C.S., 45/09 –mendimi i 25 prillit të vitit 2013


13. GJUKANOVIQ, Rada dhe GJUKANOVIQ, Radmilla, 67/09 & 140/09 –mendimi i 25 prillit të vitit 2013
14. FILIPOVIQ, Marija, 92/09 –mendimi i 25 prillit të vitit 2013
15. MARINKOVIQ, Svetllana, 94/09 –mendimi i 25 prillit të vitit 2013
16. PAVIQ, Jordanka, 98/09 –mendimi i 25 prillit të vitit 2013
17. D.P., 04/09 – mendimi i 6 qershorit të vitit 2013
18. S.P. dhe V.GJ., 06/09 & 55/09 –mendimi i 6 qershorit të vitit 2013
19. NEDELKOVIQ, Nadica, 46/09 –mendimi i 6 qershorit të vitit 2013
20. RUHANI, Ruhan, 85/09 –mendimi i 6 qershorit të vitit 2013
21. MILENKOVIQ, Snezhana dhe MILENKOVIQ, Momqillo, 168/09, 169/09 and 312/09 –mendimi i 6 qershorit të vitit 2013
22. RAJOVIQ, Millorad, 308/09 –mendimi i 6 qershorit të vitit 2013
23. X. 326/09, 327/09, 328/09, 329/09, 330/09 – mendimi i 6 qershorit të vitit 2013
24. JOKIQ, Velibor, 323/09 – mendimi i 6 qershorit të vitit 2013
25. MAJSTOROVIQ, Dragica dhe STEVANOVIQ, Sllavica, 42/09&128/09 –mendimi i 31 korrikut të vitit 2013
26. PESË ANKESA, 43/09, 54/09, 114/09, 173/09 dhe 242/09 –mendimi i 31 korrikut të vitit 2013
27. PAVIQ, Stana, 47/09 –mendimi i 31 prillit 2013
28. SPASIQ, Sllobodanka, GJOKIQ, Jagodinka dhe NEDELKOVIQ, Cveta, 221/09, 273/09 dhe 336/09 –mendimi i 31 korrikut të vitit 2013
29. STANISHIQ, Milevka, 49/09 –mendimi i 31 korrikut të vitit 2013
30. POPOVIQ, Stana, 56/09 –mendimi i 31 korrikut të vitit 2013
31. CAMOVIQ, Sllavica, 23/09 –mendimi i 31 korrikut të vitit 2013
32. ÇUPIQ, Olivera, 278/09 –mendimi i 31 korrikut të vitit 2013
33. G.R., 12/09 –mendimi i 21 gushtit të vitit 2013
34. M.M. dhe V.M., 35/09 –mendimi i 21 gushtit të vitit 2013
35. NIÇETIQ, Verica, 69/09 - mendimi i 21 gushtit të vitit 2013
36. ZHIVKOVIQ, Dijana, 71/09 - mendimi i 21 gushtit të vitit 2013
37. OGAREVIQ, Zhivorad, 77/09 - mendimi i 21 gushtit të vitit 2013
38. MILENKOVIQ, Liljana, STOJANOVIQ, Marica, MILENKOVIQ, Dalibor dhe MILENKOVIQ, Lubisha, 97/09, 332/09, 335/09 dhe 345/09 - mendimi i 21 gushtit të vitit 2013
39. STEVIQ, Tomislav, 50/09 –mendimi i 11 shtatorit të vitit 2013
40. D.I., 57/09 - mendimi i 11 shtatorit të vitit 2013
41. LUSHIQ, Zllatibor dhe Zoran, 70/09 and 108/09 –mendimi i 12 shtatorit të vitit 2013
42. MILLADINOVIQ, Zufe, 86/09 - mendimi i 11 shtatorit të vitit 2013
43. ANTIQ, Vesna, 100/09 - mendimi i 12 shtatorit të vitit 2013
44. ZH.I., 145/09 - mendimi i 12 shtatorit të vitit 2013
45. P.S., 48/09 –mendimi i 31 tetorit të vitit 2013
46. TODOROVSKI, Milivoje, 81/09 - mendimi i 31 tetorit të vitit 2013

47. GOGIQ, Milisav, 135/09 - mendimi i 31 tetorit të vitit 2013
48. GJ.L., 88/09 –mendimi i 21 nëntorit të vitit 2013
49. GJURICA, Katica, 79/09 –mendimi i 25 nëntorit të vitit 2013
50. VITOSHEVIQ, Olivera dhe VITOSHEVIQ, Arsenije, 90/09 dhe 103/09 –mendimi i 27 nëntorit 2013
51. STOJKOVIQ, Nenad, 87/09 –mendimi i 14 dhjetorit të vitit 2013
52. MINIQ, Miljana, 101/09 dhe 107/09 –mendimi i 13 dhjetorit të vitit 2013
53. BULEVIQ, Lubica, 146/09 –mendimi i 13 dhjetorit të vitit 2013


Mendimet: Asnjë shkelje 3(3)

1. ZDRAVKOVIQ, Snezhana, 46/08 –mendimi i 25 shkurtit të vitit 2013
2. MANOHIN, Vlladimir, 27/09 –mendimi i 2 gushtit të vitit 2013
3. R.A.,41/09 –mendimi i 13 dhjetorit të vitit 2013

Shtojca E



Shtojca F



Shtojca G

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

DOJ – DD – Departamenti i Drejtësisë
DPPO - PPQ- Prokuroria Publike e Qarkut
ECHR - KEDNJ- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
ECtHR - GJEDNJ- Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
EU – BE – Bashkimi Evropian
EULEX – Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë
HRAP-PKDNJ- Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut
HRC – KDNJ – Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
IACtHR – GJNADNJ- Gjykata Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut
ICMP – KNPZH – Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur
ICRC – KNKK- Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
KFOR – Forca Ndërkombëtare e Sigurisë (zakonisht e njohur si Forca e Kosovës)
KLA – UÇK - Ushtria Çlirimtare e Kosovës
MMP – PZHV – Person i Zhdukur/i Vrarë
OMIK- Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në Kosovë
OMPF –ZPZHML – Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore
OSCE – OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
SRSB – PSSP- Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
UN – KB- Kombet e Bashkuara
UNDP – PKBZH Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNGA-KPOKB-Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara
UNHCR – Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNMIK – Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë